

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

8JH-32  
M 98

flora  
mullaymeri  
**si u bëra  
fotografe**  
treqime



8 Sh - 32

M. 98

FLORA MULLAYMERI

# SI U BËRA FOTOGRAFE

t regime



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## SI U BËRA FOTOGRAFE

Isha punonjëse e kooperativës së shërbimeve në qytetin tim të vogël. Në organikë unë figuroja si llogaritare-arkëtare, por.....

— Shoqja Besa, — më fliste drejtori me tonin e njeriu që s'ka se nga t'ja mbajë, — shoqja Besa, sigurse e dini, Irini shkoi në zborin ushtarak, ikë disa ditë ardej nga floktaria e grave. Në floktari unë vija me njithë qejf dhe arësyet kuptohen kur dihet se unë kam vajzë e re. Por nuk kalonin shumë ditë dhe përsëri:

— Shoqja Besa, në repartin e lavanterisë!  
— Shoqja Besa, në repartin e rrobaqepësisë! Besa! Në repartin e...

Një ditë kërkoi leje për në dasmë mjeshtër Xhemali. Dhe, apo u nis ai, drejtori më thirri:

— Shoqja Besa!

Më dogji... «me të vërtetë drejtori do të më nisi në vend të gjysh Xhemalit. Të rrah hekur në kudhër?»

Por jo. Drejtori më priti me krahët rrëzuar poshtë dhe për herë të parë vura re disa thinja të reja mu përmbi ballin e tij. Punë e vështirë të drejtosh

një kooperativë shërbimesh në një qytet! Kujt t'ja prishësh e kujt t'ja ndreqësh!

— Shoqja Besa! Fotografi Petro u sëmur: S'dihet sa kohë vazhdon sëmundja e tij. Ai repart ka mbetur prapa; ti merr aparatin dhe fillo nga puna... kështu është natyra e punës sonë... të gjithë duhet të mësojmë nga shumë profesione...

Ngeca e nuk dija nga t'ja mbaja. Unë, vajzë, të bëhem fotografë? Deri më sot s'ka parë vajzë fotografë qyteti ynë i vogël. Ç'do të thonë njerëzia përmua kur të sillem rrugëve me aparat në krah duke u buzëqeshur kalimtarëve dhe: «urdhëroni, shokë, një pozë për kujtim». Pastaj... unë s'e kisha zënë kurrë aparatin me dorë... a ishte e mundur...?

Desha ta shoh drejt në sy drejtorin (ndoshta kështu i bëja të ditur mendimet dhe shqetësimet e mia). Por ai as e kishte mendjen fare te unë. Urdhërin e tij ai e quante urdhër dhe pikë. Megjithatë, ngaqë, u zura ngushtë, desha diku ta kapja drejtorin tim:

— Ç'flisni kështu, shoku Bajram, unë nuk e njoh fare procesin e kësaj pune...

— Oh, ç'farë procesi! Ti vajzë me shkollë... përsë njoftime mbi fotografinë artistike mund të t'i jap dhe unë brenda dy minutave... objekti në qendër, gradimi te zerua, te pesa, te...

— Po larjen e filmit, e harruat, shoku Bajram?

— Jo, jo, ti s'ke pse ngatërrrohesh në atë punë. Për larjen e filmave hëpërhë s'të ngarkoj ty, mbaro filmin dhe dergoja kooperativës së qendrës, ata e lajnë dhe na e kthejnë, ti sa të bësh pozat, faturat, lekët... plani, ti e kupton...

Kur e pashë ngushtë, nuk di se si, por fare ve-

tiu, sytë m'u mbushën me lot, e buza m'u drodh.

Veç tani, drejtor Bajrami përqëndroi vështrimin te unë dhe më pa me vërejtje. Mblodhi buzët, i mëritur, kapi me nervozizëm lapsin e kuq të skrivani-së dhe foli:

— Rini prej lecke. .! kur isha unë si ti. . .

E ndjeva se Bajrami më goditi rëndë dhe nuk desha ta lija të vazhdonte. Unë e di se ai do të thoshte akoma «e kam ngrënë barutin me grushta» dhe ai do të mendonte edhe shumë të tjera, ashtu si e kanë zakon disa të moshuar, që përqmojnë brezin e ri dhe ja fillojnë e ja mbaronjë mëngjez e mbrëmje duke kujtuar luftën dhe sakrificat.

Asaj nate nuk fjeta fare. Njëmijë mendime më silleshin në kokë. Nuk dija si të bëja e nga t'ja mba-ja. «Unë, vajzë, të dal me aparat në qafë! Ç'do të thonë njerëzia kur të më shohin? Kjo s'ka ndodhur kurrë. E di se në mbledhjen e rinisë do të më kritikojnë për koncepte e për mbeturina e për. . . pa le ta provojnë ata vetë. Mirë se shoqeve mund t'u përgjigjëm kështu, po shokëve? . . . po, mund t'ju them pa shkoni ju dhe punoni në çerdhet e fëmijëve, ose shkoni në kopshtin me drekë e delni rrugëve shëtitje me fatosat, duke i mbajtur varg njëri pas tjetrit pas dore. Po kjo është për më tutje, tani si t'ja bëj? Si t'ja bëj drejtorit, që më hodhi edhe atë gurin e tij «rini prej lecke»? . . . Apo të marr aparatin dhe të mbyllëm në laborator, kush të dojë, të vijë e të fotografohet atje. Po mbështet kështu do të jetë më keq, sepse plani nuk realizohet. Pastaj dihet se Petrua gjithë ditën punonte nëpër rrugë, nëpër shkollat, nëpër oborrin e kombinatit të sheqerit, nëpër. . . Si t'ja bëj? Disiplina në punë, detyra, mosha ime, konceptet...

Më në fund, të nesërmen në mëngjez, e mërzitur dhe më sytë të skuqur nga pagjumësia, mora aparatin në krah dhe dola. Për çudi, askush s'po më shihte me ndonjë vështrim të habitshëm. Secili ikte në punë të vet, të njohur ose shoqe më përshëndetnin si ngahera. Por shpejt i rashë në të. Më shihnin me aparat në qafë dhe mbasse mendonin se kaloja rrugës për në shtëpi. Askujt s'i shkonte ndër mend se unë isha bërë nga llogaritare fotografë. «Pa guxo, Besa, pa guxo e u fol kalimtarëve: «Shokë, një pozë për kujtim, kujtim i bukur, vetëm një lek...!»

Ja, këtë nuk e bëja dot. Ika në oborrin e shkolles. Atje munda të fotografoja disa grupe vajzash dhe e kuptova se ato e bënë këtë më shumë për hatrin tim, por unë, sidoqoftë, vura re edhe disa vështrime të habitura edhe te vajzat. Disa syresh edhe pëshpëritën diçka. Atë pasdite, i gjithë qyteti im i vogël e mori vesh se unë kisha dalë me aparat në qafë... si fotografë!

Të nesërmen në mëngjez pashë qartë shumë veta që më shihnin nga larg me vështrime ironike. Disa nënqeshnin hidhur, disa edhe mblidheshin qoshe më qoshe e bisedonin për mua. Ndoshta mua më dukej ashtu. Ku ta dish!

Por s'kishte kaluar as gjysmë ore nga dita e dytë e punës simë si fotografë, kur... tre çuna, aty nga mosha 10-12 vjeç, m'u qepén pas dhe ja nisën britmës!

— Ua... çupë fotografë! Ua, çupë fotografë! Ua, çupë fotografë! — Bëra të largohesha, por ata s'më ndaheshin, më ndiqnin pas! Ua, çupë, çupë...! U bërtita një herë. Por tani ata u bënë më të paturpshëm dhe filluan të thërrisin më keq. Një grua

nxori kryet nga dritarja, në duar kishte një shkop me ca lecka në majë, të cilin e përdorte për të fshirë muret, e tundi në erë, si ta kishte flamur dhe ja bëri me shenjë fqinjës së saj kundrejt, në anën tjetër të apartamentit. Dhe të dyja ato shkëmbyen nga një vështrim tallës, kurse e dyta thirri:

—...qyqja, qyqja... e bija e Nefaretit!

M'u përparrë meje u stepën tre djem. Me një të parë, vura re se ishin të huaj. Kuptova se vinin nga kryeqyteti; duhet të ishin studentë që bënin praktikën e shkollës në TEC-in tonë.

— A na fotografon një herë, o shoqe?

Kreva detyrën time dhe me duart që më dridheshin u preva deftesën. Mezi shkruaja. Duart tradhëtonin gjendjen time të brendshme, por kur ngrita kryet, rreth meje e grupit të djemve, ishin mbledhur mjafit njerëz.

— Ua, çupë, çupë!

— Fëmijë të bezdissħem! — tha njëri nga studentët. — Ça, dreqin, kanë kështu?

Por në grupin e fëmijëve më i paturpshmi ishte inipi i Meros. Merua ishte ai plaku në lagjen lart që merr pension dhe kurdoherë është në ballë të njerëzve që zënë radhën te qumështi ose te mishi. Merua ishte edhe nga fshati im i lindjes, por ja që, edhe pse ishim bashkëfshatarë, fëmijët nuk më linin të qetë. Ata përsëri bërtisin dhe deshën që t'u bëreshin shokë edhe fëmijë të tjerë. Atëhere mendova t'i drejtohesha Meros vetë. Mora rrugën. Sikur ta dinin, të tre nipat e plakut më ndiqnin pas dhe bërtisin:

Ua, çupë! Çupë fotografë!

Kalova plepat e lagjes lart, hodha urën, mora

nga e majta, nëpër oborrin e gjatë me lesë prej dërrasash të holla, dhe trokita në derë. «Sigurisht që Merua s'ka pér të qenë, do të jetë plaka.» Por u gabova. Në derë u dha Merua vetë, i zi, i gjatë dhe i kërrusur, me leshrat mbi ballë, me gjoks të shkopsitur, ku i dallohej leshi i thinjur dhe... mu në mes të gjoksit i varej e palarë dhe e fërkuar nga djersa një goxha hajmali. U çudita. Hajmalive ua kishim harruar emrin, kurse Merua e mbante akoma në qafë. Nga hutimi, s'po ja hiqja sytë që andej. Si më pa ashtu, ai mbështolli shpejt e shpejt këmishën që të mos i dukej hajmalia.

— E moj çupë e Hasanit, ç'kërkon?

I shpjegova gjendjen. Plaku mblodhi një herë ato buzët e tija të trasha e të zgjatura tej masës nga mungesa e dhëmbëve dhe ma ktheu:

— Epo, fëmijë janë, ç't'u bësh? Pastaj, ti kur na dole kaq e mençme? Mirë të thonë, është turp edhe pér fshatin 'tonë...

— Të lutemi shumë, xha Mero, sepse jemi dhe tanët (desha ta marr me të mirë), të lutem, u folë fëmijëve...

Po ai m'u kërcënua:

— T'u flas fëmijëve, apo më mirë të të marr këtë shkopin dhe të të futem... ku na dole ti kaq e zgjuar, të vërtitesh rrugëve si kareshë. Jazëk, Do të vij te yt atë sa po të kthehet nga Tirana... ta hoqi frerin jot'emë.

E kuptova se kisha gabuar që kisha ardhur këtu. Dhe me t'u nisur, të tre fëmijët e shtëpisë së Meros do të më vërsuleshin më me egërsi. Kjo ishte fare e kuptueshme. Por në çast diçka më shkrepi në kokë. Nuk di sesi ndodhi ashtu,

as që e kisha të qartë, por gradova aparatin për hije dhe, në çastin që Merua po tundte dorën përpjetë si ta kishte shpatë, dhe gjoksi i qe zbuluar dhe i dukej hajmalia, e fotografova shpejt e shpejt dhe nuk harrrova t'i thosha: me shëndet!

U largova gati e tërbuar, e ndjekur nga kori i fëmijëve rrugaçë... po në çast u ktheva dhe i fotografova edhe këta...

Te drejtor Bajrami hyra duke qarë. Kurse ai më priti duke qeshur.

— Mirë, o vajzë, mirë. Lëre aparatin, shko në arkë, rini...

Kafshova fort buzën, që më dridhej. Tani m'u duk se më kishin kapur plotësisht ethet e luftës dhe të ndeshjes. Tani s'kisha për t'u tërhequr në asnje mënyrë.

— Shoku drejtor, ju po tërhiqeni...

— Kur ti u theve me kaq lehtësi prej një të mykuri, unë çfarë të bëj, si të sillem me ty?

— Po fare papritur dera u përplas, dhe në drejtori hyri, si i prishur nga mëndtë, vetë plaku Mero.

— Dëgjon, apo jo? Ti direktor, t'ja mbledhësh kësaj pele, se jo po ndryshe, do t'ja jap leshrat në dorë. Më ardhj gjer në shtëpi dhe le që më çau kokën me pallavra, po, pa pikë e turpi e pa pikë surrati, më nxori në resmë... mua, në këtë moshë, që jam gjyshi i saj, ptu, jazëk të qoftë, do t'ja jap leshrat në dorë, lermëni...

Plaku m'u vërsul. E ndjeva në krah dorën e ash-për dhe të shëmtuar të Meros. Dhe, e egërsuar si isha, u tërhoqa me vrull. Ai u lëkund nga tërheqja ime dhe, po të mos e kishte mbajtur drejtor Bajrami

ai kishte për të rënë. Dridhej i téri dhe, ndërsa thërriste, i kërcenin pikla pështyme.

— Duhet të më vihet nderi në vend. Ç'kishte kjo pelë që më nxori në resme mua...

Ika në shtëpi dhe nuk qaja, vetëm dridhesha. Por... pas pak, më thirrën. Shkova te drejtor Bajrami.

— Tani besoj se u qetësove, Besa... unë kisha shumë shpresë te ti, por, nëse ti tërhiqesh, edhe unë s'kam ç'bëj.

— Jo, shoku drejtor, s'kam për t'u tërhequr, jo... Por çfarë shpresash kiske te unë?

— Ti je vajzë me shkollë, me kulturë, lexon shumë, dhe unë të kam zili. Ti flet për libra, për filma dhe për çfaqje dhe flet aq bukur, sa mua më pëlqen, por vetë nuk e kam atë nivel që ke ti. Unë, duke të dërguar ty në repartin fotografik, mendoja se je pikërisht ti ajo që duhet të mbash dhe të drejtosh atë repart. Ti e kalove disi provën e parë në zanat. Mund të të dërgojmë edhe në qendër për të perfekcionuar zanatin... Fotografia është art e kulturë. Ti mund të flasësh më mirë për këtë çështje. Kisha menduar shumë gjëra. Na është kërkuar që laboratori ynë të çelë një ekspozitë me fotografi artistike, ja ku e kam edhe shkresën. I kam thënë disa herë Petros, por ai nuk sheh punën e artit këtu, por planin, tejkalimin, borderonë... ti po... nxjerr pretekste të tjera, ja dhe shkresën e varrosim dhe...

— Të lutem, shoku drejtor, mos vazhdo më. Nuk dua ta dëgjoj më atë çështjen e «leckës» as unë dhe as shoqet e shokët e mi. Juve ju ra barra e luftës dhe e mbajtët, edhe ne, po të na binte, do ta kishim mbajtur...

\* \* \*

«Ekspozita s'ka për të qenë e nivelist?» Le të mos jetë. Do të duket si shumë diletante? Le të duket. Çdo fillim kështu e ka.»

Shkova në bibliotekën e qytetit të qendrës dhe mora ç'më duhej. Shfletova librin: «C'duhet të dijë një fotograf.» Titulli gabim. Pse jo fotografë, por fotograf?... Po sikur të më jetë djegur ajo poza? Ajo poza e Meros. Jo, nuk ka si të jetë djegur, unë s'jam fataliste. Tani, Besa, në sulm! Gati për ekspozitën! Le të dalë si të dalë, por do ta bëj!»

U nisa menjëherë për në floktarinë e grave:

— Fatime, ndiz dritat e mëdha, qëndro atje të ajo nusja që po i bën permanentin. E, ashtu. Gati? Me shëndet, Fatime! Që aty renda në Kombinatin e sheqerit, në sallën e madhe të sitave, atje ku derdhet sheqeri si lumë nën kujdesjen e grave dhe të vajzave. Pamja, është madhështore, sallat zbardhin përbukuri, dritat janë të forta!

— Aneta, ju lutem shumë, përvishini llërët gjer përmbi bërryl. Sa më të qeshura. Milenë, kokën më lart. Ti, Nilka, ngreji supat dhe jepi gjoksit përpara. E ashtu. Gati. Me shëndet!

Që nga Kombinati, në Fabrikën e alkoolit. Këtu shumica janë gra. Renda në repartin e shatrivaneve, ku derdhet alkooli brenda vazove të mëdha prej kristali:

— Katerinë! Buzëqesh dhe kape me të dyja duart atë manometrin e derdhjes. Ti, Lila, bëj të duket sa më shumë ajo përparësja e bardhë. Sytë te aparatet! Me shëndet!

Në tē dalë, pashë autobusin urban. Në timon  
Bukuria.

— Bukri! Xhan i motrës!

— Ikë, Besa, se s'kam kohë, po ç'dreqin ke?

— Të lutem, Bukri, he ashtu, mbi timon, pak  
më ashpër vështrimin!

Ajo s'u mbajt dot dhe ja shkrepi gavit.

— Po mos qesh, moj Bukuri, të lutem.

— Po s'kam pare.

— Nuk tē dua pare. Hajde, me shëndet!

Hyra në dyqanin e rrobave tē gatshme:

— Argjiro, të lutem!

Ajo hapi krahët, e habitur. Por e kuptova se  
atje s'kishte dritë sa duhej.

— Argjiro, më bëj një nder. Ju lutem, një mi-  
nutë ju klientë. Argjiro, hyrë në kafazin e madh tē  
vitrinës, do tē tē marr që matanë xhamit. E, ashtu.  
Falemnderit, Argjiro!

Rrugën pér në qytet e kapërceva me një frymë.  
Në bashtat e mëdha tē kooperativës bujqësore po  
mblidhnin mollë. Kalova nëpér pirgjet e mëdha tē  
mollëve. Po këtu kishte shumë gra, kurse unë kër-  
koja vajza, shoqe tē mia. I gjeta, më në fund,  
në starkinget e gjata. Këtu ishte më vështirë.  
këtu punohej me shkallë tē larta. Edhe mua  
kështu më duhej.

— Ti, Marie, dhe ti, Drita, edhe ti, Noi, ju lutem  
shumë, ngjituni mu në majë tē drurëve, përvishni  
llërët dhe buzëqeshni. Ti, Arsinoi, lëshoje pak nga  
e djathta atë kaçurrelën rebele. Dhe qeshni. Me  
shëndet!

Renda nga vreshtat. Veshulët më tē mëdhenj i

gjeta afër hendekut. Por njeri nuk kishte fare këtu. Bëra pak çape më poshtë. Ishte atje një nga stacionet e linjës urbane. Njerëz kishte plot, dhe autobusi s'po dukej. Hyra midis tyre. Dikush më hodhi një të tallur:

— O shoqe, na nxirr një herë në fotografi:

Ndoshta e kishte dhe me të vërtetë, por mua më kishin hipur ethet e luftës dhe as që e përfilla. Gjeta një shoqe.

— Tefta, mirëdita. Jam ca e nxituar, por dua të më ndihmosh. Sikur ta dish se sa shumë ta kam nevojën dhe sikur ta dish se përsë do të vlejë kjo, do të më ndihmosh...

— U... fjalë e ke atë? Si e ke punën?

I tregova.

— Po, jam nisur për në qytet. Pastaj... më këto rroba...

— Ca më mirë, ti kooperativiste je.

— Ashtu jam.

— Eja pas meje.

Hymë nëpër vargjet e hardhive. Përballë na doli rojtari.

— Po ju ç'bëni këtu?

— S'kemi ndër mend të vjedhim, Bektash. Ja, do ta shikosh.

— Po pse, s'u sosin çairet për të dalë me kadro?

— Të lutem, Bektash, pastaj të shpjegoj. Tefta, përkulu paksa pas trungut, kape atë veshulin e madh, buzëqesh... u, moj korbë, sa të tepruar e ke atë dekolte!

— Jo, po u kërrusa, ti ashtu më the...

— Mirë, mirë, mos u druaq.

Mbi kokrrat e verdha të rrushit të pjekur kishte

bulëza të bardha vese, ato xixëllonin përbukuri. «Po vallë do të m'i kapë objektivi? Ama ç'e humbas! Do t'i kapë përbukuri. Objektivi im do të kapë edhe atë buzëqeshjen aq të ëmbël dhe mitureshte të Teftës...»

— Më rrofsh, motër, dale të të puth njëherë!

\* \* \*

Dhjetë ditë me radhë s'më kapën këmbët dhe. As që pyesja fare pér ata që më hidhnin romuze. Përkundrazi, i shihja mirë, kthehesha mbarë dhe i fotografoja. Dhe nuk kishte vetëm burra, kishte edhe gra. Por unë i kisha hyrë luftës, nuk desha të tëriqesha. Në revistën «Shqiptarja e re» lexova një artikull mbi gratë në botën kapitaliste. Atje thuhej se në Zvicër, gratë, pér të fituar të drejtën që të votonin, ishin shtrirë mbi shinat e trenave...

Gratë e botës kapitaliste! Rrezikojnë jetën pér të drejtat e tyre. Unë tëriqem, sepse del Merua me shokë. Jo, nuk tëriqem!

Brenda javës kreva edhe kërcimin tjetër. Mësova të laja filmat, të stampoja, të dalloja letrën, markat, masat e elementeve kimike, markat e aparateve, mënyrën e përdorimit. Por filmat e parë, mbi të cilët isha mbështetur në luftën time, nuk i lava vetë. Kisha frikë se mos më digjeshin.

Pas dy javësh, në sallën e kino-klubit te qytetit, unë çela ekspozitën. Sa shumë telashe kishte ajo! Në të parë duket diçka e vogël, e parëndësishme, por, pa t'i hysh punës?

Tani drejtorin e kisha në krah, ai më ndihmoi me gjithë zemër, dhe ditën e diel, në orën 10...

Unë pandeha se do ta hapja vetë sallën dhe më kaq. Por nuk ishte kështu. Bajrami kishte vepruar fshehtazi meje. Në orën 10 në mëngjerez, në sallën e madhe të kino-klubit ishin mbledhur gjithë ata njërrëz. M'u skuqën faqet dhe balli gjer në rrëzë të flokëve. U habita, por kjo s'ishte asgjë... papritur, disa zhurma motorësh qëndruan në rrugën përjashta dhe... tani e humba fare toruan. Po vinte sekretari i partisë së rrethit, pas tij shokë të tjerë, gjithsejt një 20 veta. Në fillim m'u morën mendtë por pastaj e ndjeja veten të lehtë si pupël dhe për asnjë çast nuk më iku e skuqura e fytyrës. Duart më digjeshin. Isha plotësisht në ethe. Por këto ishin ethe të tjera, jo ato ethet e shqetësimit kur nuk përbahesha dot dhe kur qaja si foshnjë. Drejtor Bajrami mbajti një fjalim të tërë, urime e përshtendetje. Pastaj sekretari i partisë preu një shirit të kuq. Unë isha atje dhe, duke mos e patur mendjen fare, zgjata dorën nga sekretari i partisë, kur ai preu shiritin e kuq... Ai gati sa nuk më lëshoi në dorë gëershëren e vogël, por shpejt e mblohti:

— Jo..... juve nuk ju takon gërshëra... gërshëren ta marrë kjo vajza që mban diskun këtu. Ti, Besa, pa na pri përpara, udhëhiqna dhe na trego fruetet e punës sate...

Një banderolë e madhe në krye: Ekspozitë fotografike e amatores Besa... pastaj pak më poshtë ky mbishkrim: Gratë dhe vajzat e qytetit tonë.

Isha e gjëzuar në kulm, nuk ecja, fluturoja në-për parketin e ndritur të sallonit të madh. Zemra më buçiste në krahëror. E përshkova krejt sallonin. Dhe ku më ardhì aq shpejt ajo gojë, ajo gjuhë, ato shpre-

hje! I shihja një pér një gjithë fotografitë që vetë i kisha gatitur dhe më dukej sikur nuk i kisha bërë unë. Dhe, kur arritëm përsëri te dera nga ku hymë (nga ana tjetër), e humba dhe isha gati të delja kur sekretari i Partisë më mbajti pér krahu dhe më foli:

— Pa dale, ç'bën ti, kërkon të ikësh, këtu ku ja vlen të qëndrojmë një ditë të tërë!

Qëndrova. Përpara kisha fotografinë e zmadhuar të Meros, më hajmalinë e tij në qafë, me atë gjoksin leshtor, me atë vështrimin tinzar, të hutuar e keqdashës. Sipër ishte shkruar: «Këndi i të prapambeturve».

— Bukuri. Ky na qenka Merua, — foli sekretari.

U habita. Nga mënyra se si fliste ai, patjetër do të kishte mësuar mbi ato «ditët e mia të vështira». Me siguri që kishte dëgjuar.

— Mirë, Besa, bukuri, ky është Merua vetë, po këta çunat këtu?

— Këta janë nipat e tij...

— Mirë ua ke punuar...

— Po këta tipat këtej?

— Këta janë disa prej atyre që më hidhnin fjalë ditëve të para, prej atyre që talleshin; kishte edhe të tjerë, por unë zgjodha vetëm këta.

— Natyrisht, rastet më tipike... Urime!

Shkoja përgjatë ekspozitës e shtyrë nga gjithë ajo turmë njerëzish dhe nuk di... isha e hutuar apo e lumtur... vetëm ndjeja që zemra më rrihte fort... ndjeja gjithashtu edhe vështrimet e njerëzve dhe s'dija si t'i kuptoja, vetëm e ndjeja: Më të shumtë ishin dashamirëse, po ndjeja sikur vjedhurazi më ndiqte edhe vështrimi i egërsuar i Meros.

## NJË NATË NË VENDLINDJE

Aty nga fundi i vitit shkollor, me tri shoqe të mia shkuam në krahinën malore, ku kam lindur vëtë. Një shtegtim i tillë, për të mbledhur fjalë të rra-lla e shprehje të popullit, përbënte për mua një rast jo të zakonshëm. Dhe ishin dy arësyet që më dhanë një gëzim të pamasë e një entuziazëm të ti-llë, sa dy ditë e dy net me radhë u prega-tita e thuajse s'vura gjumë në sy. Së pari, sepse po shkoja në vendlindje e, së dyti, nuk po shkoja-dosido, por po nishesha gati si një punonjëse shken-core (të paktën, mua kështu më pëlqen ta them!) në shërbim të gjuhësisë.

\* \* \*

Djepi im ishte përkundur në vendlindje këtu e gati 20 vjet më parë. Dhe, kur ika unë prej andej, isha e vogël. Ashtu të vogël, e mbaj mend veten ti-me, që e shihja përditë në faqen e «Burimit të bilbi-lave», me ca faqeza buçka e me ca bukla të verdha në kokë, që mamaja m'i zbukuronte përditë me lu-

~~2770~~



le nga tē livadhit ose me lule tē kuqe nga tē oborrit.

Por babai punonte minator nē një qytet tē vogël. Ai hapte me qysqi brima pēr tē futur pastaj dinamit-in dhe...

...Një ditē prej ditēsh ndodhi ajo shpērngulja e familjes që nga malet e egra nē luginat mē tē bu-ta tē fushës, këtej ku rrитеj misri nē tokë tul e ku mérzente edhe ngjala shtegtare.

Largimi nga vendlindja éshtë një ditē nga ato tē rrallat nē jetën e njeriut. Mbaj mend një mën-gjez tē tillë: Drita e diellit dukej lart e larg nē qiell, por fshati im ishte nē një hije tē plotë, që pasqyro-hej nga korijet pértej, ku edhe po vërtitej errësira e po ngriheshin avujt e natës.

Disa teze e halla qanin e mē puthnin e mē puth-nin, sa si pēr çudi shpëtuan atij mëngjezi faqet e mia buçka! Sepse m'i thithën aq fort, sa lëkura ime e trëndafiltë prej fëmije mē digjte, e sytë mē lotonin.

Më hipën nē kalë, mē vendosën sheshazi nē mes tē samarit, anembanë kisha velenxa tē trasha e jas-tëkë tē ashpër prej leshi dhije. Tani tezet e përlotura më shihnin veç kryet e më dërgonin tē puthura tē tjera prej atyre, që unë mund t'i duroja një shekull tē tërë.

Zu tingëllonte zhurma e bakrit, se po varnin e po ngarkonin kusira e tenxhere, pastaj diku nē samar varën atë mikun e vjetër tē vajzës së vetme — tiganin e vogël me faqe tē ndritshme prej kallai e me kurriz tē zi prej bloze.

Unë nisa tē lëkundesha, pastaj lëkundja ime u kaloi maleve, korijeve, arave dhe shtëpive tē gurta tē fshatit. Nisën tē lëkundeshin edhe tezet, që vazh-donin tē qanin, ndërsa mua mē d'gjnjn faqet. E pér-

fytyrimi im pér «botën e largët», që do të zbulojë paskëtaj, më bënte të gëzoheshë.

Tani më dukej se kali nuk ecte, por notonte në një lumë të padukshëm, e unë shihja sesi më parakalonin korijet e mëdha me breza shkëmborë, që rrethonin kodrat e malet, ashtu si rrathët e hekurt shtrëngojnë butet e mëdha të verës.

Ata breza të atillë gurësh, që i kam parë vetëm ndër anët tonë, më ngjalnin një emocion të tillë, sa s'mundëm ta harroj kurrë. Pér një çast, ato duken sikur i ka vendosur dora e njeriut në një epokë të largët, kur punonin skllevërit, kur koskat e tyre formonin pirgje me kafka dhe eshtra. Renditje të tillë shkëmbinjsh zbuluan sivjet në trasenë e hekuru-dhës, dhe mallëngjimi e mahnitja ime ishte e dyfishtë, sepse m'u kujtuan gurët e vendlindjes. E njëkohësisht pamë me sy gjurmët e rrugës Egnatia, të mbuluara nga muzgu i shekuve.

Pra, duke u larguar atëhere nga vendlindja, duke «notuar» nëpër ajrin e lagësht të mëngjezit, u lija lamtumirën kopeve me gjënë e gjallë, kodrave me ahe e pllajave me vreshta, kecave, që ishin kacavirur pas trungjeve dhe që zgjatnin kryet, duke lëvizur buzët e buta, sikur më uronin «rrugën e mbarë» pér në «botën e madhe». Ikja atëhere e shihja druvarët tek prisin dru e si sëpata qëllonte në trung e sesi krisma e saj vinte te unë tepër vonë.

---

Kaluan 17 vjet që atëhere, Kisha ikur fëmijë e po kthehesha vajzë e rritur. Unë e njihja vendin me pëllëmbë e më bëhej të thërrisja «Mirësejugjeta» gjithë kopshteve me mollë, të vjetrave e të rejave... më vinte të përqafaja drurët e të puthja gurët. Më vinte të përkëdhelja ferrat e drizat, këtu ku më hynin gjemba në këmbë e ku tok me Dilen mblidhnik qershi e lyenim faqet me lëngun e tyre.

Çudi sesi ka shpërthyer forca e njeriut! Kur dolëm në Lirëz, sytë m'u vranë nga reflektimi i rrezeve përmbi llamarinat e ndritshme të një godine të madhe. Godina, në anë të xhadesë, nxirrte ca zhurma të njobura dhe përhapte anembanë disa tela të trashë, që, duke ndriçuar nëpër ajër, merrnin rru-gë e iknin larg nëpër fshatra e kantiere.

Pastaj hymë në fshat dhe, duke u përbajtjut me mundim, «të shohim kush do të më njobë!», dëgjova dikë që foli brenda në oborr:

— Dilni të shihni çupën e Sulos... qenka bërë tamam nuse!

Por unë ecja përsëri e përsëri faqet më ishin ndezur aq fort.... thuajse si ditën e ikjes: U mundo-va të mbahesha gjer në fund, po, kur arrita te vendi ku ishte ngarkuar tigani i vogël i vajzës së vete-me, nuk munda... nuk munda... aty doli një nga ato tezet e dhembshura, që nuk i zgjata dorën, por ju derdha në grykë e pa një pa dy ju lëshova ndër krahë. Faqet e mia tanë mund të duronin edhe se-pse të puthurat e tezes s'e kishin më forcën e 17 vjetve më parë.

Rinia asaj nate jepte shfaqje estrade në sallën e vatrës së kulturës.

S'arrita t'i shihja shoqet e vogëlisë në rrugë,

as në shtëpi as te sheshi i madh. I pashë në skenë duke interpretuar, i pashë në skenë duke kënduar, i pashë duke hedhur valle. Dhe zemrën e kisha plot nga gëzimi. Më kërkonin t'i mësoja, më kërkonin të bëhesha regjizore, kurse unë vetë kisha ardhur të mësoj prej tyre.

Harrova pér një çast pse kisha ardhur. U shkri-va e tëra me këta njerëz të mirë malësie, prej të cilëve kisha dalë e prej të cilëve kam mësuar të çapi-tem.

Nga fundi i çfaqjes, shkova prapa skenës, se nuk e mbaja dot gëzimin që më kishte pushtuar.

Te një derë qëndronte një njeri i panjohur, me një sëpatë në duar, i parruar, i veshur me shajak të zi e me ballin të rreshkur e të rrudhosur. Ishte gjithë nerva e inat. Mbante erë bulmet e duhan e diç shan-te dhe... sapo u mbyll skena me perden e trashë prej doku blu, njeriu i panjohur hyri atje e nisi të bërtiste:

— S'ju di unë ju? Jeni veç pér tralala... u marrasët pas valleve e krisët e ikët... kush e kishte lënë hapur portën e stallës? ikën bagëtia në pyll...

Mendova se tani do të pëlciste sherri, më shkoi mendja te historitë e gjyshes pér shamatat e zënkat e kaluara, kur fshatarët rrightheshin e vriteshin pér hiç mos gjë...

Por gjithë ai gëzim nuk mund të përmbytej nga një «kérkim llogarie» i brigadierit të blegtorisë.

— Do t'i gjejmë ne... pas mbrëmjes... se kemi mbrëmje vallëzimi.

— Nisemi në çast.

— Niseni ju, po përgjegjësinë e kam unë se...

Shoqja ime Dile! Është kaq e dashur dhe kaq e mirë, kaq e ëmbël dhe kaq punëtore! Ajo vallëzon

me sytë ulur, e emocionuar dhe jo lirshëm.

— Pa më mëso mirë ti...

— Të mëson motra ty, po nuk më thua, Dile, thérresin burrat pér këto?

— Disa thirrën sa thirrën, tani s'thonë më gjë, se u lodhën... neve na pëlqen kështu...

— Po Merikua... Dile, si i ka punët me Etemin? Dëgjova gjer në Tiranë se...

— Merikua? Etemi? I kanë hedhur miqësisë pleh kimik...

— Çfarë?

— Superfosfat!

Në fillim më ardhì si e papritur kjo frazë, pastaj qesha, më pastaj desha të nxirrja bllokun nga xhepi i tutave. Por:

— Mos e shkruaj këtë... se kë të shkruash më parë?

— Pse?

— Si pse? Iku koha e errësirës, tani të gjitha vajzat e kanë zgjidhur gjuhën...

— Edhe ti, Dile...

— Ta merr mendja...

— Ti, Dile, do të më ndihmosh pér punën që kam ardhur?

— Sa të më vijë pér dorësh... motra pér ty...

Afér mesnatës dolëm të gjejmë kopenë e viçave, që kishin marrë malin. Të themi të drejtën, s'dëgjova njeri të qërtonte «atë që harroi» të mbyllte portën e stallës. Madje do të desha të them të kundërtën. Sa pér vete, unë e urova atë, cilido që të ishte, vajzë a djale, sepse na dha rastin t'i biem pyllit mes pér mes nëpër errësirë, kur hëna rendte nëpér qiell, sikur mundohej të na ndihmonte e të na

tregonte nga ishin e nga kullošnin viçat nëpër natë.

Thërriste Dilja duke ndjellë mëzatët e vegjël, e përfytyrimi im rendte prapa viteve të shkuara, atëhere kur nuk dija as të flisja as të ndjeja e as të dija se ka një bukuri natyre nëpër natë e nën hënë, kur malet duken si kështjella gjigante, e zjarret dallohen si dritare të kullave.

Ishim një grup prej tre vetash. Tok me ne kish-te ardhur edhe Xhaferri, shoku ynë i vogëlisë, por që atëhere hiqej ca më i madh. Ky na printe përpara dhe na thoshte:

— Thërrisni ju, se zëri i vajzave dëgjohet më mirë...

Dhe ne ndillnim bagëtinë, dhe ata mundoheshin të mbanin të qeshurën me belbëzimet e mia:

— Ke harruar!

— Ke harruar!

— Kam harruar!

— Viçat duhet të jenë andej nga pllajat me tër-fil.

— Andej duhet...

— Duhet, sepse tani gonxhet me tërfil rëndohen nga lëngu i ëmbël, e mëshqerrat s'i ndahen dot.

Xhaferi flet e s'pushon e unë mendoja se këtë «gatishmëri» e humor të tij e kishte për mua, miken e porsaardhur.

Nuk i ngopеша dot bukurisë magjepsëse të natyrës nëpër natë, fërfërimës së fletëve dhe uturimës së erës, gurgullimës së ujërave dhe gurëve, që binin e përplaseshin e iknin tatëpjetë.

Diku pas ferrave vura re se kordelen e flokëve s'e kisha më. Ku më shkoi? Mos ma rrëmbeu ndo-

një ferrë, apo ma rrëmbeu era. Apo ndoshta ma rrëmbyen vajzat e përrallave të gjyshes...

Mbeta prapa një çast e mahnitur: fjalët e Xhaferit s'dëgjoheshin më e as zëri i Diles, që ndillte viçat e humbur... Dhe unë kuptova! Dhe unë u gëzova... Dhe unë s'u habita fare, kur zëri i Diles kishte një dridhmë të tillë, sikur të ishte i mallëngjyer...

Më ardhì një nënqeshje eëmbël në fytyrë, shpirti m'u gëzua e m'u duk sikur kordelja ime e flokëve kishte ikur e kishte flutuar atje në gonxhet eëmbla të tèrfilit.

Pylli u mbush plot me thirrje, poshtë e lart dukej drita e fenerëve, e pastaj vargje me mëzatë që i zbrisnin tatëpjetë. Dolëm te një shpat i egër, poshtë ishte humnera e ca më poshtë xhadeja dhe lumi i madh.

Natë. Fryn një erë e freskët, që vjen nga larg duke sjellë aromën e çajit, që rritet në malet e Lenijes.

Në anët tona malet e largëta janë të zhveshura, ujërat kanë gërryer sa kanë mundur, e prandaj shtrati i lumit, si labyrinth, është tepër i thellë e i fshehur nëpër llagëme. Nga larg po zbresin një varg kandilash.... lëvizin e gjarpërojnë nëpër lugina... janë kamionat e rëndë, që transportojnë lëndë druari. Dritat e tyre hera-herës zhyten gjer në lumë, e atëhere zë vend e s'tundesh e do që të përsëritet edhe një herë ajo zhytje dritash, që reflekton e derdh gjithë ato ngjyra.

Xhaferi ankohet se grupi ynë nuk gjeti asnë viç. Por fajin e marr vetë, se unë s'mundja të rendja natën nëpër pyll.

— Jemi te guva e Beqos, — thotë Xhaferi,

Guva e Beqos! Dhe më kujtohen tregimet e mamasë:

...«e kishim fjalën te guva e Beqos! Ata të pestë si njëri tjetri (këta ishin dajot e mi partizanë) vinin te kjo guvë. Vinte Nexhua syzi, me atë shenjën e prerë në buzë. Vinte Skënderi i heshtur e i gjallë, vinte Samiu i urtë e ai Aliu i gjatë e ca më rrallë dukej Saliu i urtë e i vogël, që vinte të shih-te motrën dhe të katër vellezërit... por një ditë s'u kthyte në shtëpi as Saliu i vogël, e dërgoi fjalë se veç pushkës në krah, vuri edhe një yll në ballë...»

Po... edhe vetë dikur e pata marrë një «yll» në ballë.

Dua tanë t'ja them Xhaferit, po s'di sesi do të ma marrë.

Njëherë, ky Xhafer, më ka qëlluar me llastikë mu në ballë, por jo me halic. Në vend të guralecit kishte vënë një qershi belice. Qershia e madhe m'u përplas në ballë e plasi... Fytyra m'u mbush me «gjak» sa mamaja u tmerrua, por pastaj qeshi, se gjaku ishte ai lëngu i belicës së madhe,

Dhe mbaj mend mirë se atëhere Xhaferit ju kanosën:

«Hap sytë, se, qoftë larg... po t'ja nxirrje synë e ta lije më mëhanë... ta sillnin në derë... e ta merrje nuse!

Dhe tek kërkoja të arrija Dilën, që e cte përpara ose prapa Xhaferit (këtë nuk mund ta shquaja dot), m'u kujtuan fjalët që ajo më tha disa orë më parë: «I kanë hedhur miqësisë pleh kimik!»

Dhe vetëm tanë u kujtova se kisha ardhur si një punonjëse shkencore në shërbim të gjuhës...

## **UNË DHE GJYSHI XHEMAL!**

Mbledhja jonë u bë në kovaçanë, meqë atje vendi i punës ishte më i gjerë. Kovaçët e ndërmarrjes sonë u ulën mbi farkat e punës, por që më parë kishin sjellë aty fronat dhe stolat e reparteve. Se ne ishim ndërmarrje e shërbimeve të qytetit të vogël, që fillonte me repartin e këpuçarëve, rrabaqepësve, berberëve për burra, floktoreve për gra, repartin e radios, orëndreqësit, me repartin e tifilikletave, kallajxhinitë e në fund repartin e kovaçeve.

Isha tepër e emocionuar asaj dite e më dridhej gjithë trupi, por më keq e kisha me buzët e me gjunjët, që nuk i përmbaja dot.

Në rendin e ditës ishte një pikë e vetme: Lutja ime për të m'u dhënë e drejta e studimit, pra, aprovimi i kolektivit. . .

Por që të jetosh kaq kohë në një kolektiv, edhe do të ndeshesh me njerëzit. E sidomos kur merresh me shumë lloje punësh, si unë, që herë punoja si radioteknike, herë hyja në arkë, merresha edhe me normat, ikja nga puna me ditë të tëra për probleme shoqërore. . .

Plakun Xhemal s'guxoja ta shihja në sy. Më dukej se kovaçi plak mbante me mua një mëri të hapur.

Kisha pandehur se Xhemali i kishte pasur me shaka gjithë ato fjalë... por kur ardhi një ditë...

Kisha një dëshirë të brendshme të punoja në kovaçane. Dhe një e dy e shkoja aty, merrja çekanin dhe qëllaja në kudhër ndonjë sëpatë që kalitej, ndonj plor, ose ndonjë detaj nga të kombinatit, që kovaçët e andejshëm ja çonin për kompetencë mjetështër Xhemalit.

Dhe këtu s'kishte asgjë për të qeshur, sepse Xhemali ishte vërtet usta i zanatit të vet.

Por usta Xhemali gjithnjë më thoshte:

— Kam një nip, djalë për kokë të djalit. I shkathët, i zgjuar, bardhosh... dëgjon ti? Bardhosh! Është këngëtar në estradë, ka dy diploma në xhep, e mban pasaportën hyrë e dil jashtë shtetit.... do të të marr nuse për nipin... ama ta dish, djalë për kokë të djalit dhe është bardhosh.... dëgjon?

Kështu më kishte thënë Xhemali që atëhere e dy vjet më parë dhe këtë ma kishte përsëritur kushedi sa herë. Unë gjithnjë i buzëqeshja plakut, duke u druajtur të hyja në hollësira.

Në ndërmarrje kishte edhe njerëz që me shaka ose gjvsmë për gjysmë, më thërrisin: «O nusja e Xhemalit!»

Por Xhemali s'më ndahej: — Dëgjon ti, është bardhosh e ka dy diploma!

Natyrisht, çdo vajzë i përkëdhelet sedra e kreneria kur e kërkojnë, kur i propozojnë, kur i çojnë letra, qofshin këto edhe anonime si: «Nëqoftëse je dakord për martesë, do të të pres në x vend...» .

Po ja ardhi dita që unë bëra lutjen për të drejtën e studimit. Përmbajtja e saj u përhap nëpër të gjithë punonjësit. Këta e bisedonin çështjen, e shoshtnin... madje disa shoqe të floktarisë së grave edhe më uruan «udhën e mbarë e suksese». Veç në pushimin e mesditës, tek po uroja «Ditën e mirë, gjysh Xhemal!», plaku, gjithë hundë e buzë, s'm'u përgjegj me gojë, por më bëri shenjë me dorë që të mos ikja, po të futesha në farkë, atje ku ai po më priste...

Unë u binda, ju afrova, ngrita krahun e kapa shtizën e kacekut dhe e ula. Vërshoi oksigjeni në zjarr, dhe thëngjijtë u përskuqën.

Gjithnjë, sa herë hyja në atë repart gjatë pushimit, më pëlqente t'i fryja zjarrit dhe, nëpër atë fryrje e shfryrje të kacekut, do të dëgjoja edhe fjalët e gjysh Xhemalit: «Ai nipi, im...»

— Ke bërë lutje për të shkuar në shkollë të madhe!

— Po, gjysh Xhemali...

Ai po dridhte cigaren, dhe e pashë që ju drodhën duart...

— Po ne e kemi pasur një fjalë, o vajzë... Vëtëm tani e kuptova se plaku e kishte pasur me gjithë mend. Ndjeva se gjaku më rendi nëpër fytyrë, ashtu sikurse ndjeva që plaku ishte shumë i fyter.

—... po, gjysh Xhemal, unë di se ju e keni pasur me të qeshur.

— C'ka për të qeshur këtu?

— Po ja, zakonisht të moshuarit u thonë të rinjve fjalë të tillë, pastaj, në kohën e sotme, si është

e mundur? Edhe ai nipi yt, s'kishte për ta pranuar një gjë të tillë.

— Jo, jo... ti për të mos folë... se kur të vijë dita, ai s'ka për të ma prishur, se më ka gjysh, kurse ti... ka dy vjet që me gojën plot: «Gjysh Xhemal e gjysh Xhemal» e sot kërkon të ikësh për katër vjet në shkollë... e përse pa... për të mësuar bejte...

Ai s'foli më. As vetë s'fola, por asnjeri s'tundej të largohej. Më vinte keq sinquerisht për atë plak, që dridhej nga emocioni dhe shkak për këtë isha unë... po s'dija çfarë t'i thosha e si ta ngushëlloja.

Rrinim atje kryeulur, afér farkës, që mbante erë kaçavel të djegur, blozë dhe hekur të skuqur. Një erë e lehtë frynte nëpër hatullat, kurse që nga çatia, lëshonin një të kuq të çelët tjegullat marsejeze, ngaqë u binte sipër dielli i ngritur në zenit.

Nuk di sa kohë kaloi, por me siguri aq sa në shtëpi u bënë merak për vonesën time. Ndjeva një të ecur të njojur në rrugë e sidomos trokitjen e shkopit të gjyshit tim të vërtetë, që po kalonte nga reparti në repart për të më kërkuar mua.

Kur hyri në farkë, im gjysh ngeci. Nuk dinte si ta shpjegonte heshtjen tonë... kokët e ulura, lötët në sytë e gjysh Xhemalit dhe ftyrrën time të shqetësuar....

Im gjysh më nisi për në shtëpi dhe më vonë mësova ato, për të cilat më vjen turp kur i kujtoj.

Midis pleqve ishin ndezur një zënkë, që kishte mbaruar me fjalë të hidhura. Fjala e fundit e gjysh Xhemalit kishte qënë:

— E kuptoj, zoti Islam, e kuptoj. Ti e paske

hallin te soji e te fisi... ju si familje paski mendi-dime të mykura...

Kjo ngjarje më bëri atëhere të mos i dal më përpara gjysh Xhemalit. E kështu s'plotësoja dot as atë dëshirën time për të rrahur hekurin e skuqur në kudhër, për të punuar shtizën e kacekut dhe për të dëgjuar atë cërcëritjen e hekurit të nexhtë «kur i japin ujë»

Dhe sot, mbledhja e kolektivit për lutjen time.

Gjysh Xhemali, kokëulur, rri në krye të farkës. Buzët i ka të shtrënguara, është i parruar, me ca gjurmë të zeza në qafë e në zverk. Janë gjurmët që lënë çurkat e djersës, që, në një punë të rëndë si kjo e kovaçit, nuk reshtin gjithë ditën.

Edhe se jam shumë e shqetësuar, bëj çmos që të takoj qoftë edhe shkarazi vështrimin e gjysh Xhemalit. Dua t'i buzëqesh me shpirt të larë, dua t'i shpjegoj me zemër se unë nuk e përqmoj, përkundrazi, e dua, e respektoj, e nderoj. Dua t'i them për të njëmijtën herë se gjyshi im bëri ndaj tij jo një gabim, por një faj të pafalshëm... por më kot! Kovaçi plak nuk m'i jep sytë asnjëherë. Ai rri atje, ulur mbi kudhër, me çekanin nér duar, që e sheh me vërejtje, thua se s'e ka parë kurrë ndonjëherë.

Edhe sot në mëngjez im gjysh, kur u nisa në punë, më hodhi një «Bela me atë djall Xhemal, s'bëra mirë që u përfola.»

Por im gjysh nuk e tha këtë se e ndjeu gabimin, por se parashihte rrjedhimin e keq të fajit të tij përmua.

Mbledhja filloi. Atë e çeli Tefta, kryetarja e komitetit profesional.

Shquajnë ndër të gjitha shoqet flokët e saj të

bukur, fytyra e hijshme, dhëmbët e bardhë dhe sytë e kaltër.

— Sot në këtë mbledhje marrim në shqyrtim lутjen e shoqes Lira, e cila kërkon nga ne aprovimin për të vazhduar shkollën e lartë...

Heshtje. Në të gjithë farkën sundon ai çasti i fillimit të mbledhjeve, kur secili mendon: «Unë do të flas i dyti...»

Por nuk kaloi gjatë dhe njerëzit, fjalën e të cilëve e prisja me ankth, filluan të ngriheshin një nga një.

Kur unë s'e prisja fare, u ngrit Xhemali plak duke vështruar nga Tefta, por aspak nga unë.

Tek u cua, çekani i rrahu në kudhër me atë zhurmën e njohur, dhe buzët e ngjeshura e me tul të Xhemalit, u çelen. Unë u gëlltita; në atë çast, qđo gjë isha gati të shihja e të dëgjoja, por jo zërin e gjysh Xhemalit.

Në kokën e thinjur të tij dallova bulëza djerse, që sapo i dolën e që ngjanin tamam me ato sumbulat e kallajit të shkrirë, që kisha parë aq e aq herë në këtë repart.

— Shokë dhe shoqe... Si e tha edhe shoqja e kryesisë, domethënë, ne jemi mbledhur sot për të shikuar... Po ç'ka këtu për të shikuar xhanëm?... Çupa kërkon të shkojë në shkollë? Po të shkojë more! Prandaj i ka hapur shokllat Partia... po do thoni duhen shikuar ca gjëra, biografia, jo qëndrimi, jo puna. «Takor» xhanëm. Biografinë në rregull. Puna. Po ajo me ne ka punuar! Se mos ka punuar në Opar!... A ka njeri të qahet nga puna e saj? Jo! Unë s'kam për vete. Ma ndreqi radion që punë e madh dhe hakun domosdo në arkë e

derdhi. Të gjithëve në qytet ua ka ndrequr radiot... apo jo? Të shkojë çupa, ore, si të mos shkojë? Si punëtore e si njeri s'e ka shoqen, të shkojë. Unë jam më plaku këtu e ju e dini. Unë flas më të rrallë...

Deri në ditën që do të nisem janë edhe dy muaj. Dhe gjatë dy muajve, unë përsëri do të punoj e përsëri do të shkoj në farkë... e përsëri do të hedh kacavel në zjarr e do të rrah me çekan hekurin e skuqur, e përsëri do të dëgjoj zërin e ëmbël të gjysh Xhemalit. Përsëri do të jem pranë zemrës së tij të madhe e përsëri do të dëgjoj atë cërcëritjen e hekurit të skuqur «kur i japin ujë.»

## NË MAQINË

Pasi mbarova gjimnazin dhe u ktheva nga aksioni, i hyra punës për të mësuar një profesion. Qyteti im i vogël po rritet. Medoemos rriten edhe kërkeshat. Para pak kohe u hapën edhe një floktore përgjra, një rrobaqepësi speciale, nisi nga puna orëndrqësi dhe tani nevojitet edhe një radioteknik. Bëra një lutje në komitetin ekzekutiv, prita disa ditë dhe, më në fund, ja nisa rrugës së përditshme: shko e kthehu në qendrën tonë të rrethit të Korçës. Rruja është shumë e këndshme, e shtruar me asfalt, dy mbëdhjetë kilometra e gjatë. Ajo është e mbushur anash me plepa, të cilët janë rritur, e gjelbërimi i tyre është harlisur goxha. Aty-këtu, nëpër parcela, ka puse arteziane, që shfryjnë një ujë të bollshëm dimër e verë. Por ajo që të bie më shumë në sy është harku që formojnë majat e plepave përmbi rrugën automobilistike.

Duke udhëtarët përditë, fillova të njihesha me udhëtarët e përditshëm, me teknikët dhe elektricistët e TEC-it, me mjeshtrit e sheqerit të Kombinatit «8 Nëntori», zura disa shoqe laborante dhe kështu udhëtimin e bëja më të këndshëm.

Po kurrë nuk më takonte të udhëtoja më të njëjtin shofer. Zakonisht, ata punonin me turne në këtë linjë dhe ishin nga tipat më të ndryshëm. Që ditët e para u ndesha me njërin prej tyre.

E quajnë Ferdi. Është një burrë i gjatë, nja dyzet vjeç, me një palë mustaqe të holla, pak zeshkan, i hollë dhe i vemendshëm, por njeri që flet pak, ose më mirë aspak. Sepse gjer atë ditë unë s'ja kisha dëgjuar zërin.

Përjashta autobusit frynte një fllad pranvere dhe unë, ulur në sedilje, nxora krahun nga dritarja. Dorën ma rrihte era dhe kjo sikur më zbaviste. Gishtat m'i guduliste era dhe më pëlqente t'i mba ja ashtu gjithnjë. Por fare partur shoferi frenoi ngadalë, 'u kthyte nga unë e thirri:

— Ti, vajzë, fut dorën brenda!

Dhe që atë ditë, që u bëra objekt vërejtjeje para të gjithëve sa ishin në autobus, e mora inat Ferdiun. Por s'mjafoi me kaq: Nuk kishin kaluar as tri ditë, kur hyra në autobus me një shishe në duar.

Autobusi u nis. Vend për t'u ulur nuk kishte. Ju afrova motorit. Ferdiu më hetoi nëpërmjet pas-qyrës së madhe të maqinës e më pyeti:

— Ti, vajzë, benzinë ke aty?

— Me mua e keni fjalën?

— Po, po, me ju. Benzinë keni?

— Jo, kam benzol.

— Ou! Ca më keq akoma! Ju lutem, dilni jashtë. Është rreptësish e ndaluar.

— Po kjo shishe s'është e madhe.

— Po rreziku është shumë i madh... Ju lutem...

— Ndjeva se fytyra m'u skuq.

— Po a jeni në vete, shoku shofer? Unë jam vajzë. Si mund të zbres kështu në mes të rrugës?

— S'është ndonjë gjë e madhe. Shoqet e tua vetëm për vetëm u bien maleve mës për mes. Ato shkojnë në hekurudhë...

— Jo, unë nuk zbres.

— Bukur! Edhe unë nuk nisem dhe përgjegjësinë për gjithë këta udhëtarë...

Më ardhë në ndihmë shoqja ime laborante:

— Ç'bëhesh e marrë! — më tha. — Hidhe shishen përjashta... — Isha gati ta hidhja, por në atë kohë pashë se po kalonte një çiklist. E njihja dhe ju luta të ma merrte. Autobusi përsëri u vu në rrugë.

Kaluan disa ditë. Ferdiu si pérherë shihte punën e vet atje në timon. Jepte e merrte me frenat dhe diferençialin, nuk fliste thuajse fare. Gjithnjë i hesh-tur, gjithnjë i menduar dhe i ngadalshëm. Po çfarë mendonte? Disa ushtarë edhe e ngacmonin ndonjëherë tërthorazi:

— Ja kemi hipur breshkës...

— Shofer Ferdiu në timon, gjithnjë është kampion... Por ai s'u vinte veshin fjalëve. Madje një ditë i foli një shoku aty në krah:

— Le të bërtasin gjithë ditën ata. Unë punën tímë e kryej si duhet. Pastaj kush nxiton shumë, gjithmonë vonohet.

— Vonohet...!

— Po, po. Kështu është.

Një ditë, apo kaluam grykën e Pocevës, atje te kthesa e madhe, polici i trafikut rrugor, ngriti doren dhe kërkoi që autobusi të ndalej. Ferdiu frenoi dhe çeli derën: Polici hyri brenda dhe përshëndeti. Nuk e kishim parë herë tjetër këtë polic rrugor. Di-

kush pëshpëriti se ishte i kontrollit qendror, i ministrisë.

— Shoku shofer, C'janë këta udhëtarë që janë ulur mbi motor?

— Po... u kam thënë kaq herë...

— U ke thënë aq herë! Kështu e respekton ti rregulloren? Më jep patentën.

— Ju lutem, shoku oficer, unë...

— Më jep patendën ta shoh një herë.

Dola në radhët e para. Në një çast u pamë me Ferdiun sy më sy. S'di pse m'u bë qejfi.

— Kështu i respekton rregullat, ti, shoku shofer? Për të tjerët i kërkon, kurse vetë...

Pikërisht të nesërmën u përhap një thashetheme komike:

— Shofer Ferdiun e ndali policia te gryka e Poclevës dhe ja mori patentën.

— Po përsë?

— Për shpejtësi në udhëtim.

Fjala qarkulloi nëpër udhëtarët, aq sa dikush e ngacmoi:

— Shoku Ferdi, mësova se ja u morën patendën për shpejtësi...

E hetova Ferdiun nëpërmjet pasqyrës. Pashë se si u shqetësua e ju ngrys vështrimi. Kapi frenin dhe e ndali autobusin ngadalë:

— Për shpejtësi ma morën patentën mua? Po folë ti, moj vajzë, që ishe vetë këtu, folë.... Pastaj sot ma kthyen. Ja...

Mendova se kishte ardhur rasti që edhe unë t'ja acaroja, ndaj ngrita supat:

— Unë di që ta morën patentën, po përsë nuk e di... Ta shihje atëhere si u bë në fytyrë! Si mbeti

pikë gjaku. U zbeh, u zverdh, aq sa mustaqet e ho-lla ju dukën edhe më të zeza. S'e kisha parë ndonjë-herë Ferdiun as të qeshte e as të buzëqeshte. Buzë-qeshja e sotme ishte plot ironi dhe sarkazmë.

Atëhere fola shpejt:

— Jo, Ferdiu s'kishte faj.

Por ai nuk e ktheu kokën, as nuk nxori zë.

\* \* \*

Pas disa muajve ardhì dimri. Ja nisi me stuhi, të ftohtë dhe c'kmë. Natyrisht, taní shoferët e kishin më vështirë. Kalonin nëpër rrugën e akulluar, mbuluar nga degët e zhveshura të plepave. Fare pa-pritur, motori u fik, dhe autobusi u lëkund disa metra rrugë. Pastaj qëndroi në vend.

Shofer Ferdiu imblodhi buzët dhe pshëretiu. Doli, hapi kasëtën e hekurt, nxori që andej një tu-fë me lecka, i ngjeshi në bidonin e naftës dhe na-foli:

— Ka ngrirë lubrifikanti... Nga të ftohtët... Hapi derën. Të ftohtët e plakosi, po ai u hodh për-jashta. Në pasqyrën e rrumbullakët u duk një çast sesi ai u shtri në rrugë e hyri nën autobus. Se çfarë bënte nën maqinë, mund ta merrje me mend duke shikuar këmbët e tija, që përplaseshin në rrugë dhe që dukeshin në pasqyrën e rrumbullakët. Siç duket, atje Ferdiu ngrohu motorin, sepse dolën shtëllunga tymi. Era frynte gjithnjë, dhe të ftohtët të priste si brisk. Pas pak, Ferdiu i dha gaz motorit, dhe pistonat e tij sikur gurgulluan. Autobusi ni-

si përsëri rrugën. Unë mbaja kryet ulur dhe në asnjë mënyrë nuk i hidhja sytë te pasqyra që kishte shoferi mbi ballë.

Pas disa ditësh, dimri u ashpërsua dhe më. Dëbora s'pushonte ditë e natë. Në rrugën automobilistike kaloi disa herë buldozeri dhe e hoqi dëborën. Por era vinte me egërsi nga malet e Lenijes dhe i lëshohej fushës. Dukej sikur e pëرنgjonte atë gjarpërim të murmë të rrugës dhe i lëshohej si egërsirë. Nga Autobusi udhëtarët s'mund të vështronin asgjë. Dukej sikur mbi xham ishte derdhur dyllë i bardhë ose kallaj. Kalova mëngën e palltos mbi xham, bëra të férkoja, por më kot. Vec ndjenja gjer në llërë një të ftohtë depërtues. Pikërisht në këtë çast, Ferdiu frenoi. Autobusi kërcëlliti, rrotat rrëshqitën me zhurmë duke u férkuar me akullin. Udhëtarët u gjendën më këmbë. Vetë isha afër motorit, dhe gjunjët m'u ngjeshën pas kapakut të madh. U përkula vetiu dhe gati sa s'rashë mbi motor. Shofer Ferdiun një çast ktheu vështrimin nga ne, tha «Më falni», çeli derën e kabinës kësh u hodh përjashta. Motori i maqinës punonte shumë mirë. Ndiheshin vetëm dridhmat e tija.

- Po ç'pati ky njeri?
- Më duket se s'është në vete!
- Mos i doli ndonjë gomë...
- Edhe ajo na duhet...

Ai që rrinte pranë meje, nxori kokën nga dera, të cilën Ferdiu e kishte lënë hapur, dhe me një ton indiferent foli:

- Siç duket, pa ndonjë të njobur dhe shkoi

ta takojë... Njerëzit filluan të bënin zhurmë. Dikush thirri më zë të lartë të mbyllnim derën, kurse një burrë serioz, që rrinte pas meje, tha se nuk ishte e hijshme kjo që po bënte shoferi: në këtë të ftohtë të madhe t'i linte njerëzit në rrugë për punë të tij...

— E, se s'bëhet qameti, — tha një tjetër, — fundja, në shtëpi, në të ngrohtë po shkojmë.

Sakaq Ferdiu u kthyte. Shtrëngoi dorezën e u hodh brenda. Përnjëherësh hapi derën e hyrjes dhe u tha dy udhëtarëve të hapnin rrugë.

Ne pamë dy burra, që mbanin për krahu një grua me fytyrë të prishur, të zbetë. U ngrita përnjëherësh dhe i lëshova vend... kurse Ferdiu ndezi motorin, bëri tre-katër metra rrugë dhe e ktheu maqinën.

— Do të më falni, — tha — Rast urgjent. Gruaja po lind. Do të vonohemi dhjetë minuta, por...

Përsëri u kthyem në rrugën që sapo kishim bërë. Kaluam kështu nga katër kilometra, dhe Ferdiu frenoi përsëri.

— Arritëm,-u tha ai dy burrave.

— Ndihmojeni gruan.

Sikur të më kishin urdhëruar, unë kapa gruan për krahu dhe e përcolla deri te dera e maternitetit. Kur u ktheva, zura vendin që kisha. Ferdiu më vështroi duke buzëqeshur. Sytë e tij m'u dukën të bütë, të njerëzishëm.

Maqina u nis, kurse sytë e Ferdiut më vështronin përmes pasqyrës. Ishin sy miqësorë, të përzemërt...

## KARVANI I ZI

Karvani i zi po vinte. Esmaja edhe s'e kishte parë, akoma s'kishte dalë në qafën e malit, por vajza e ndjente që ai do të vinte.

Gryka e malit edhe ishte nën hijen e rëndë të majave e ajo dukej tani si gryka e një përbindëshi përrallash.

Në shtëpinë majë kodrës ishte një zhurmë e një hyrje-dalje, sa s'mbahej mend ndonjëherë. Tringëllinin enët e bakrit, përplasej petësi mbi qerthull, e gjurmë mielli mbeteshin mbi mindere. Ndërsa në qilar radhiteshin teptsitë me bakllava.

Një satër kërcëllente në hajat, kurse maçokët mjaullinin e ziheshin shkallëve.

Teze Xhixhikua, dasmorja plakë dhëmbërënë, me dajre në dorë, këndonte, ndenjur në bisht, me tumane të kuqe e me dy gjunjët hapur si biga:

*Pse je sëkëlldisur sot,  
Syri i zi mbushur me lot,  
Kam nënën, s'e lë dot,  
Syri i zi mbushur me lot...*

Bishti i cigarit i varej në buzë, e ajo këndonte duke mbillaçitur atë cigar e duke përpëlitur sytë e përskuqur e të kërcyer si pofka.

Esmanë e kishin mbyllur në odën e vogël të hamamit. Atje, sipas zakonit, do të priste vajza, veshur veç me një këmishë të hollë... e kur të vinin krushqit, do t'i hidhnin sipër fustanin e bardhë e «hajt udhë e mbarë», ku të kallësh këmbët, të rënçin dhëmbët....»

Vajza dridhej. Bënte të përbante gjurin e djathtë, por s'e përbante dot. Bënte të shtrëngonte buzët, por s'i mbyllte dot. Syri i qante, i dridhej zemra. Nëpër dritaren e vogël, ajo shihte përjashta. Fusha ishte e gjelbër nga arat e mbjella me misër. Sot brigada e saj po vadiste. Ujët po gurgullonte nëpër brazdat e gjata. Shoqet, me shatat duarve, rendnin sa nga një anë në tjetrën. Dëgjonin llokoçitjen e tokës, që thëthinte ujin, futnin pulpët e bardha në baltën e vakur, shihnin gërshtat në cipën e ujërave e pastaj, duke ngritur paksa kapelet prej kashte, shihnin edhe ato nga qafa e malit.

— A po vjen karvani i zi?

Esmaja përkulet në gjysmerrësirën e hamamit. Nga shtëpia vjen era e gjalpit të djegur dhe e kungullit të zier. Në oborr, zogëzat jariçë kércejnë nëpër gardh nga ajo zhurmë e panjohur për to.

Vajza mban duarve gërshtetin e saj të gjatë dhe majën e tij e përdredh pas gishtit tregues.

I folën shoqet e saja gjithë asaj javë, e qërtuan, e shanë, e tallën,... e çfarë fjalë s'përdorën!

— Esma, ktheje karvanin prapa, Esma!

Por vajza nuk mundej. Fjala e dhënë dhe hija e babait rëndonin mbi të, si të ishin trarët e zez të shtëpisë së vjetër.

Tani teze Xhixhikos ju shtuan edhe tri gra të tjera. Janë më shumë plaka se gra, e kënga e tyre e hallakatur e çjerr Esmanë në shpirt e në gjoks e i duket sikur me majën e një thike kruajnë një tepsi bakri.

«Shoqet po vaditin sot. Sytë i kanë nga gryka e malit, kurse zemrat i kanë te unë... më folën, më nxitën, por unë çapin s'e hodha dot. Nuk mundem!»

«Do të vijë dallga e të të marrë, por ti mos u jep... dallga po vjen. Prapa derës éshtë fustani i nusërisë. Atje prapa po pret edhe hallë Zarifeja. Karvani do të hyjë në oborr. Dhe do të kërcasë dera e vjetër e odës... dhe...»

Si i hidhet të dënuarit me vdekje një copë pël-hurë për t'i zënë sytë, ashtu edhe hallë Zarifeja, do t'i hedhë Esmasë fustanin e nusërisë.

Dhe, që ta veshë atë fustan, Esmaja do të ngrejë duart lart, do të ulë kryet poshtë, do të ulet e do të përkulet. Llërët e supet e saja të njoma, të zbuluara, do t'i rrahë halla plakë. Halla ziliqare do t'ja shkojë duart e saja të ashpra e të fishkura Esmasë nëpër krahëror e nëpër trup.

— Hajde, bijë e hallës. Sa një pelë u bëre... e mbushç shtëpinë me djem!

Këtë që hallë Zarifeja do të bëjë sot me Esmanë e ka pësuar vetë. Vajza e ka dëgjuar qindra herë, se plaka, e roitur nga mosha e nga vjetët, e tregonte dhe e ritregonte, si ai i plagosuri që nget plagët e vet.

— ...s'e di ata kam thënë, moj bijë, po ishallah s'e ke dëgjuar... Më muarr nuse në Panarit, dy ditë e tri net rrugë me kalë, të kallur në një sëndyq, që i thoshimi «maf». Mafi, moj bijë, ishte i rëndë si plumb, me ca vrima brenda e me ca vija jashtë, si bishta dja-

lli. Dy ditë e tri net hallë Zarifeja të është dërgjur në maf, dy ditë e tri net hallë Zarifeja të ka dëgjuar rënkin min e kalit, që djersinte e shfrynte, dy ditë e tri net hallë Zarifeja ka plasur e s'ka plasur dot! Tre muaj me radhë më dhembnin kryqet. Kjo ka ngjarë kur bëhej lufta me Ynanë e parë e kur në Protopapë na ishte një zabit që i therte fëmijët me thikë...»

Aty në dritaren e odës, kalon edhe kërcelli i pjergullës, që ngjet me gërshetin e Esmasë. Fletët e mëdha e gjelbëroshe hedhin në odë ngjyrën e hijen e tyre. Një bisk përdredhës është futur brenda dritares. Është ai bisku kacakvjerrës i hardhisë, që zgjatet e kërkon një kunjë që të kapet e të lidhet. U ka shkuar afër atyre kunjave si kafaz të dritares, por ndoshta s'i ka pëlqyer të kapet pas tyre e është derdhur në pezul.

«Oj, bisk i gjorë! Ku ke hyrë kështu? Këtu ka errësirë.. ikë, dil jashtë... dil në diell...!»

Esmaja me duar e nxori biskun përjashta e përtë njëmijtën herë i hodhi sytë nga gryka e malit. Karvani s'po dukej... por që do të vinte, e tregonte kënga e plakave:

— Pse je sëkëlldisur sot,

Syri i zi mbushur më lot...

S'dukej, por që do të vinte, e thoshtë zemra e saj e shqetësuar, e tregonte syri i përlotur i nënës, që vinte në derë e i fliste fjalë që ja thoshte zakoni, por kurrë zemra e nënës.

«Cili është ai që do të më marrë nuse? As që e di fare. E quajnë Qamil. I ka 27 vjet, unë jam 17. As e pashë as më pa... Ai turi derri, që ardhi te im atë, tha se «ka shtëpi me dy kate e çezmë në prak të de-

rës» I janë lutar edhe gjetkë, po s'ka dashur, se do të lidhë miqësi të fortë me miq të fortë... Metten e dua dhe më do. Ma ka thënë vetë; unë s'i jam përgjigjur dot... e dua, e dua, por s'e marr dot, se s'na lë ai kanuni i egër e i gjatë sa qindra vjet... s'martohet vajza në fshat, por larg, shumë larg... Po q'mendoj unë kështu? Karvani do të vijë... edhe s'po duket, por që do të vijë, e tregojnë...

Gjer në odën e saj u dëgjua zëri i Verës...

«S'duan ta lënë të më takojë, por unë e di se ajo do të hyjë. Ja: po bën fjalë me babanë... babai i ka hedhur ca kupa, po mundohet të përbahet. S'do ta shkelë, se pastaj i del boja fare.

— Po lëreni, moj, mësuesen të vejë te Esmaja... janë motra... lëreni, moj, që t'i ngjitet fati edhe kësaj, lëreni posi, posi...

«Por Vera s'po vjen. Mbase po e mbajnë me fjalë, mbase po e gostisin simbas zakonit. Kështu e detyrojnë të urojë e... mësuesja... eh! Sa larg ajo nga unë! Sa larg unë nga ajo!

Vera hapi derën, e ajër i ri hyri në odën e vogël. Bisku i pjergullës u lëkund në dritare, fletët e gjelbëra nanurisën hijen e tyre në dyshemenë, ku njiheshin gjurmët e Esmasë.

Ato u puthën e pastaj heshtën. Mendimet e përfytyrimet u rendnin si në ethe nëpër kokat e tyre.

«Karvani i zi, dasmorë të pirë; karvan, që vjen nga larg, që zvarriset, dredhon grykave si gjarpër. Dikur vinte me maf, sot vjen pa maf... po përsëri pakëz ndryshon... karvan që ka vrarë mijëra zemra... se edhe nëpër errësirën e kohëve fshehur janë shkëmbyer vështrime, fshehur janë dridhur zemra,

fshehur janë përkëdhelur faqe e janë shtrënguar duar, fshehur janë tundur shami, si shenjëza e si premtimë dashurie. Por karvanët e zeza i kanë hedhur poshtë e i kanë prerë, ashtu si kosa e mprehtë pret barin e njomë...

«Babai merr gazeten përditë dhe e lexon me dëshirë. Në shtëpinë tonë nuk jetojmë më si në kohën e mafit, por hija e zakoneve rron akoma në kohat e disa prindërve tanë!

Vera e kapi Esmanë për supesh, që i dridheshin si purtekë, dhe i foli ngadalë.

— Ata vijnë... por a e di pse? Sepse nuk ndjejnë turp për këtë që bëjnë. Pra, duhet që atyre t'u vijë turp! Ta ndjejnë veten si ajo molja kur i heahin sipër naftalinë!

— Po mjaft u çmallët, moj çupa...

«Babai shtihet si i shkujdesur, por ka frikë dhe prandaj ardhj.»

— Ngrehu, o Vera, shko tani... se për ty e prishëm edhe zakonin... Esmaja tani duhet të bëhet gati...

— Po dale, baba Istref, shpejtështë... karvani s'po duket.

— S'duket, por ai do të vijë...

Vajzat u puthën e pastaj u ndanë. Në qafë të malit u duk karvani.

Esmaja u drodh e tëra, sikur një rrymë elektrike t'i kalonte nëpër gjunjë e nëpër krahëror. Tani ishte vetëm rië odën e saj. Kërcelli i pjergullës dukej nëpër dritat. Plakat ja nisën këngës më me duf:

*O kjo gush' e nuses  
E bardhë si shkuma,*

*Lele un' i mjeri  
Ku rashé, ku humba...*

«Qenka ndryshe kur thonë: Do të vijë dallga e  
dallgen që vjen. ~~Jal tarvani po~~  
~~tarvani po~~  
e... dy ditë e tre net rrugë, andej nga ka lindur hallë  
Zarifeja... «mua më sollën e më dhanë 50 vjet më  
parë, ty të japin 50 vjet më vonë, që të rrojë zakoni e  
të vejë kandari në vend...»

Esmasë ju mbush gusha me djersë e ju tha  
gryka.

«Karvani po vjen... pa dale... nga rruga dhe  
arave duken shata që lëkunden në erë... Po vjen  
në dasmë brigada ime... po vijnë të më përcjellin...!

«Ose tani, ose kurrë! Të ndahem nga shoqet,  
nga njerëzit, nga...»

Ajo desh të shqiptonte emrin e atij, por s'arrij-  
ti, se mu në dritaren e vogël, mu në hijen e gjelbër  
të fletëve të pjergullës, ju bë se i doli fytyra e tij...

«Ai, në është burrë, le të më dalë zot...»

Esmaja kapi rezen e hekurt të derës dhe e mby-  
lli nga brenda. Do të delte nga dritarja... Por ishte  
ai farë kafazi i rrallë... ishte ajo farë trine prej dru-  
ri të gdhendur, si një ferrë në dritare.

Kunyat janë të zbardhëllýera, të rrahura nga  
shiu, nga era e dëbora e të djegura nga dielli. Në  
faqet e tyre njihen brima të vogla, që janë hyrje la-  
birintesh të krimbave.

Vajza kapi kunyat dhe tendosi muskujt e llërë-  
ve. Trina u shkëput nga përvazet me një krismë të  
çjerrë... në pezull irodhi tallash i mykur, i kalbë-  
zuar, tallash krimbash.

Pastaj ajo kaloi nga dritarja nëpër fletët e pjer-gullës e u gjend në oborr... dhe askush s'e pa...

Te lëmi i madh kishte ardhur gjithë brigada, e ajo andej u lëshua.

— Nusja, iku nusja...!

Në shtëpi të Istref Dautit kjo s'kishte ndodhur ndonjëherë e në të gjithë krahinën s'mbahej mend.

Kur karvani u dha te lëmi i fshatit, këtu sherri kishtë plasur me kohë.

— Posi, ore, pos! Qënki mbledhur gjithë pijnikët e Oparit dhe dashki aheng...

— Turp, o burra, turp! Kështu ju mëson Partia juve!

... Vinte erë raki, djersë e duhan kërxhall...

Tani, dajreja s'ndihej më, e veç teneqekat e saj zukatnin ngadalë, si grerat në vapë...

## NË SHTËPINË TONË

(*Tregim i jetuar*)

Nëpër natë ndiheshin hapat e tyre të shqetësuar. Ishin hapa të rëndë e të zhurmshëm. E, ngaqë ishte mezi i natës e nuk ndihej asnjë frymë njeriu, ata hapa pothuajse të kallnin frikën në atë qetësi të akullt.

Më tej, te kthesa e rrugës, fërfirinte një dritë e dobët maqine. Hapat drejtoheshin drejt saj. Mbas disa çastesh u ndje motori i maqinës, që uturiu me zhurmë e që përpiu brenda zhurmën e atyre hapave...

Shoferi, një djalë babaxhan, i qeshur, me ca sy të ndritshëm, me një nishan të zi në mjekër e me duar të lëshuara mbi timon, s'priti sa të uleshin të dy pasagjerët, por i dha gazit aq fort, sa ata të dy u përplasën pas sediljeve të taksisë. E pastaj njëri nga ata foli:

— Jepi, vëllaçko! Kemi udhë të vështirë e të gjatë.

— Në mëngjez jemi atje, — foli shoferi.

Ai buzëqeshi, duke nxjerrë një palë dhëmbë të

bardhë, e pastaj papritur ja mori një këngë. Ajo-këngë ishte e gjëzuar. Zëri i atij shoferi ishte melodioz, po, për çudi, Shpëtimit (Shpëtimi ishte pasagjeri, që nuk e kishte hapur gojën fare e që rrinte si i ngrirë) nuk i ardhi mirë që ai këndonte aq fort... ose pa u bërë merak për hallin e tjetrit.

E përsëri i buçitën veshët nga fjalët e asaj këngë:

*Vash' e bukur, moj vashë,  
Kur ti flije qet  
E plot gaz èndërroje ndoshta ti për mua.  
Un në torno hekur gdhendja shpejt e shpejt  
Dhe mendoja për dy syt e tu...*

Desh ta ndërpriste atë këngë, po të qe e mundur, do t'i binte xhamit me grusht e ta thyente... që ai shofer çapkën të mos ndihet më. Por e pa të udhës që ta ndërpriste thjesht që shoferit të mos i mbetej hatri... a ndoshta të mos e kuptonte fare...

— Byrazer, a do të mbërrimjë vallë deri në mëngjez?

Shpëtimi edhe vetë u çudit nga zëri i tij. Ishte një zë i hollë, i vrarë, që shoferit i bëri përshtypje. Ai e la këngën, e mbajti timonin me një dorë, ndërsa me tjetren ledhatoi dorën e Shpëtimit mbi sediljen prapa shpinës së tij. I ardhi keq kur pa atë fytyrë aq të vrarë e ata sy të përskuqur.

— Mos u mërzit. Erë do ta bëj maqinën. Do të të ndihmoj me shpirt... pastaj, pse ke frikë a do të mbërrimjë deri në mëngjez? Është mësuar kjo «sor-kadhja ime» edhe me rrugë të vështira... Dhe, si mori frymë thellë, ai shtoi:

— Ehu... sa nuse kanë udhëtuar me mua!

Të dy pasagjerët vështronin tani atë shofer të ri, që ledhatonte me duar timonin, prekte lehtë se diljet, sikur të ishin sende me shpirt... dukej se ai kishte një shpirt të ndjeshëm...

— Po nuk më thua, a të do vajza?

— Këtë do ta tregojë sot, — u përgjegj Shpëtimi nxituar.

— Po ti... a e do?

Sytë e tyre u takuan një çast. Ata të Shpëtimit sikur thoshin: «Eh, vëllaçko, e ç'më pyet... po, a do ta kisha marrë vallë gjithë këtë rrugë?»

Shoferi heshti. Nuk desh ta ngacmonte më gjatë, megjithëse kurreshtra e brente për të mësuar se si kishte ndodhur. Para se të nisej, kishte marrë vesh vetëm se ishte fjala për një «rrëmbim», diku larg, në Veri të Shqipërisë, dhe... asgjë më tepër.

«Eh, ç'gjëra ndodhin në jetë!»

Dhe përsëri Shpëtimi foli:

— Hë, si thoni ju... a do t'ja dalim dot mbanë?

Shoferi dhe shoku i tij e panë të habitur. Ndoshata edhe ata këtë çast prisin.

— E pse të mos ja dalim? Ty Mimoza të do, ndryshe s'do të niseshim kot...

— Po, — tha i menduar Shpëtimi, — po ku dihet: presioni, frika, dashuria për prindërit... pastaj, ku dihet ç'i ka ndodhur?

— Ohu, ato léri! Ai që do, i merr parasysh të gjitha!

— Po nga shtëpia pse iku? — u dëgjua papritur zëri i shoferit.

As Shpëtimi e as shoku i tij, Nikua, nuk e dinin sepse kishte ikur Mimoza...

Atë pasdreke ata ishin takuar si gjithmonë. Ndërsa mëngjezin e ditës së nesërme, ai kishte marrë vesh se Mimozën e kishte marrë i kunati me vete. Vëtëm kaq.

— Po sikur ajo vetë të mos dojë të vijë? Ku dihet... Mbase i është këthyer mendja... se martesa i do edhe konditat. Unë jetoj thjesht, në një dhomë begari. Ajo mbase do të donte të jetonte më rehat... ta gjente shtëpinë gati, me të gjitha të mirat... që unë tani për tani nuk mund t'ja siguroj dot...

— Eh, i lojtur! Po pyet dashuria nga lëkto, mor katran?

— Pyet, s'pyet... mua te e keqja më shkon mendja.

— Hajde, more, mbaje veten! — Foli Nikua. Mos fillo të na qash... se vetëm kjo të ka mbetur tani, — dhe, duke u kthyer nga shoferi, i foli ëmbël:

— Jepi, byrazer, jepi asaj «sorkadhes» sate sa më shpejt, se, siç e ka zënë ky, do të na mallëngjejë edhe ne.

Nikua fërkoi duart me njëra-tjetrën e pastaj i rrahu supin Shpëtimit:

— Hë de, qesh! Po qesh, o lumëmadh, qesh... sesot kemi dasmë!

Sytë e Shpëtimit shkrepëtinë.

Ata qeshën të tre; maqina rrëshqiste shpejt mbi asfaltin e rrugës. Dita sapo kishte filluar të hapte. Ishte koha kur akoma rrezet e diellit s'kanë dalë, e nata sapo bëhet gati të fshihet... e akoma duket hija e saj e stërmadhe...

\* \* \*

Nga larg u dukën kreshtat e maleve, që qarkonin qytetin e vogël të metalurgëve.

Ndonëse ishte akoma shpejt, në qytet kishte fillouar ajo lëvizja e zakonshme e njerëzve, që nxitojnë të fillojnë turnet e mëngjezit.

Që nga dritaret e pallateve dy-trikatëshë herë-herë nxirrin kokën fëmijë të përgjumur dhe diçka u kujtonin prindërve si: «Babi, mos harro, të mablesh sot atë librin me përralla!» ose ndihej zëri i ndonjë nëne të shqetësuar: «Të keqen nëna, kujdes kur të hysh nëntokë....!

Nga një dritare e tillë vërente edhe Mimoza atë turmë, që po largohej para syve të saj, veshur me atorrobat karakteristike të minatorëve. Ajo vështronte e shqetësuar dhe priste nga çasti në çast që të kerciste dera dhe të shihte të kunatët dhe të motrën të delnin nga shtëpia.

«Ç'të kenë vallë? Pse nuk po shkojnë në punë? Ja, shumë pak kanë mbetur pa shkuar. Gjithë ajo turmë u shpërnda sakaq, sa hap e mbyll sytë... Po këta?»

Aq e gjatë ishte kjo pritje, sa Mimoza nuk po e duronte dot.

Së fundi e kuptoi. Ata, si duket, nuk do të shkonin në punë. As ai dhe as ajo! Kishin frikë! Sa të mësohej Mimoza në këtë ambient... pastaj rrethanat aq të vështira, gënjeshtra, që kishin kurdisur për ta sjellë deri këtu... deri në njëfarë mase i trembte. Ditet e para, ajo me siguri nuk do të ndjehej e qetë, madje, ata kishin frikë se mos....

Jo, jo! Ata as që e mendonin! T'u ikte ajo, që mezi e kishin sjellë deri këtu?

Ishte mëngjezi i dytë ky, që po kalonte në këtë vend. Mimoza as e kishte hapur gojën fare. Të motrën e kishte vështruar rrëptë, me ata sytë e zez, dhenuk i kishte folur fare. Dukej që e përbuste të motrën.

«E, të lumtë, bukur ma hodhët! Kënaqu tani tek më sheh kaq të vrarë... po kot e kini, nga Shpëtimi s'më ndani dot!»

Në darkë, e motra ishte mundur ta qetësonë, ta bindte se ajo do ta kuptonte, më në fund, se sa mire do të ishte këtu.

Dashuria është si flaka e kashtës, Mozë, dëgjoje motrën. C'më gjeti mua, që s'u martova me dashuri? Pastaj, ai nuk është as në gjendje të mirë, një copë palaço që lot estradave, gjithë ditën me tralala, s'ka as shtëpi, ndërsa këtu... që sot ta gjejmë një inxhinier. Ti je e bukur... e kush nuk të merr ty? Të kemi gjetur edhe punë... në laborator...

— Si!

Moza kërceu përpjetë. Pastaj e mbajti veten.

— Dëgjo Lina. E shoh se ti je mirë këtu. Po unë s'do të rroja dot kështu si ti. Burrin se ke dashuruar kurrë. Do të thuash: «Ashtu qe koha atëhere». Ke të drejtë. Po kohën njerëzit e bëjnë. Sa vajza kishte në kohën tënde që nuk pranonin të mar toheshin pa u njobur. Sa dashuroheshin? Me qindra. Dhe ti nuk guxove... Unë, unë... u nisa e ardhë këtu vetëm se të kam dashur shumë... kujtoja se ti nuk do të ishe kundër mëje, kundër dashurisë sime. Kujtoja se ti e ke peng martesën tënde... se ti s'mban mend kurrgjë nga rinia jote. Ishe vajzë e

mbyllur, s'vije as në punë, vetëm qëndisje... të thanë për një njeri, pranove... e u martove menjëherë...

— Kush tha që e kam peng martesën time?

— Unë ashtu mendoj. Po edhe mund të mos jetë e vërtetë. Po ti, a nuk duhet të ishe njeriu më i afërm për mua?

— Jam...

— Jo? Kurrë. Po ti më gënjeve, më fute në kurth. Kjo është e ulët. Si nuk ju vjen turp... dhe yt shoq është komunist, e, çfarë komunisti...

— Moza! Turp të kesh. Përpiqemi për mirë, dhe na e shpërbulen kështu.

— Nuk dua të përpinqeni më për mua... dhe as të mundoheni të më mbani këtu. Ju s'keni asnje të drejtë... unë do të iki... dhe dëgjo: Te Shpëtimi do të shkoj! Dhe jo nga inati... por sepse e dua.

Mimoza ishte zverdhur në fytyrë. S'e mblidhët dot veten nga ky mashtrim që i kishin bërë.

Sillte ndër mend turbull atë natë në shtëpi... Dy ditë më parë kishte ardhur Musai (i kunati). Dhe ajo vinte re se, sa herë hynte ajo në dhomë, njerëzit e shtëpisë e ndërprisnin bisedën dhe heshtnin.

Mesnatë. Nëpër gjumë ajo ndjeu zhurmë. Ju duk se shihte ëndërr, por befas një dorë e tërhoqi pas supit.

— Ngrehu, Moza!

Ajo, e përgjumur, duke ngritur vetëvetiu me njérën dorë këmishën, që i kishte rrëshqitur, arriti të vishte një bluzë. Dhe brofi më këmbë.

— Ç'është, ç'ka ndodhur?

— Telegram nga Lina, është keq...

Sytë e Mozës hapen tej masës. Ajo shpejt e

shpejt e hap telegramin dhe, duke mos e besuar atë që i thonë, e kontrollon:

«Jo, telegrami është në rregull...»

I kunati pret te dera. Ai do të niset në çast. Moza e vështron e hutuar atë njeri me shtat mesatar, që ka filluar të vejë bark, me ato duart e vogla e gjithë tul... dhe që është i kunati i saj! Dhe sepse i nevertitet!

— Moza, ti duhet të nisesh me Musanë.

— Si! Të nisem? Po unë jam në punë...

— E kemi... (desh ta mbaronte fjalën i ati, por shpejt, gati i turbulluar, foli):

— E rregullojmë ne për lejen.

Dhe ajo heshti. As e mendoi se ky ishte një kurth. E motra, e gatshme «t'i vinte në ndihmë», kishte vepruar tamam pas porosive që i kishin dhënë. Në datën e caktuar kishte dërguar telegramin.

Dhe ajo u nis. Kur arriti te e motra dhe e pa shëndoshë, as ju afroa fare, as e pyeti gjë. Por u ul e heshtur, e dërmuar, e vrarë...

\* \* \*

Një rreze drite hyri nëpër dritaren gjysmë të hapur. Mimoza u drodh e fërgëllroi. Nëpër flegrat e hundës ndjeu ajrin e ftohtë dhe të lagësht të mëngjezit.

Befas, veshi i kapi një vërvshëllimë të njohur. Ajo u rrëqeth. Këtë melodi e vërvshëllente gjithmonë Shpëtimi kur donte ta thërriste që nga dritarja e shtëpisë.

Mimoza tani s'e përfytyronte dot Shpëtimin. Mundohej t'i sillte ndër mend sytë, por ishte e pamundur... I kishte të zez, gështenjë... të kaltërt? Jo, jo! S'ishte në gjendje t'i përcaktonte tani... vetëm dinte që sytë e tij ishin të qetë, të butë, të qeshur e të bukur.

Vërvshëllima u përsërit.

«Si! Është e mundur vallë?»

Ajo brofi më këmbë, hapi me vrull kanatat e dritares, por në çast u step. Mbeti e zhgënjer. Nën dritaren e saj qëndronte tjetër njeri, që dinte ta vërvshëllente aq mirë atë melodi. Ajo e mbylli prapë dritaren dhe zuri veshët që të mos dëgjonte asgjë. Por ishte e pamundur. Herë-herë i bëhej se ai zëri atje poshtë përsëriste edhe emrin e saj.

«Jo, e pamundur!»

Dhe veshët i buçisnin më me forcë, lotët ju mblohdhën te mjekra e i shkonin tatëpjetë mbi gjoks. Ajo përsëri e hapi dritaren. Dhe përsëri e pa atë njëriun që vërvshëllente, po këtë herë diç i bënte me duar... ca shenja...

«C'njeri... nuk arriti ta mbaronte mendimin ajo, se pak më tej, pa te dera e një taksie një siluetë të njojur. Ajo zgjati kokën më përjashta dritares dhe... e njuh. Ishte Shpëtimi!

Ajo u mundua të përbante veten, duart i shtrëngonte mbi gjoks, sikur të kishte frikë mos i fluturonte zemra prej atje... As vetë nuk diti si doli nga shtëpia, ashtu siç ishte, me flokë të shpupurisur, me pandofla të lehta plastike...

Dhe fluturoi. Hyri brenda në taksi. Atje e tërhoqën me forcë dy duar të njoitura dhe... për çudi, ai njeriu që vërvshëllente poshtë dritares rrrotulloi ti-

monin, dhe maqina u nis duke lënë prapa atë qylet të vogël, që akoma dukej i hirtë nën dritën e bruztë të agimit.

Maqina ecte me shpejtësi; ajo, duke gulçuar me zor e duke u përpjekur të mbante ngashërimin, nuk e kishte mendjen fare t'i përgjigjej vështrimit të hu-tuar të Shpëtimit.

Befas, ajo ju fut në gjoks dhe u shkreh në vaj. Ai i mori fytyrën ndër duar dhe, si i marrë mendsh, mundi të belbëzonte:

— Ti..., je ti?

Me sytë e lagur, me mjekrën, që i dridhej, ajo shtrëngohet fort pas gjoksit të tij dhe papritur pësh-përiti:

— Po tani, ku do të shkojmë?

— Ku? Në hënë...! në fund të botës...!

Ajo u mundua të buzëqeshte. Dhe qeshi përmes lotëve. E atij ju duk se shkrepri dielli në sytë e saj ë bukur, që vetëtinin nga lotët. Dhe, si i de-hur, foli:

— ...në shtëpinë tonë...!

## SHQETËSIM PËR NJË MOTIV

Në krahinën e Dibrës, ku shkova me një ekip, u interesova të gjeja një subjekt për tregim. Por s'të ecën gjithnjë puna e mirë. Sepse të gjithë shpejt e shpejt i gjetën subjektet e tyre, madje, edhe nga dy e tre, kurse unë ngeca.

Një shoqja ime poete shkoi te «Kopshti i Gjonit», i treguan se atje kishte pasur shtëpinë dhe kopshatin e tij Gjon Kastrioti, i thanë se aty më poshtë ishte «Terzishtja», ku Skënderbeu qepte rrobat e ushtarëve të vet... dhe shoqja ime shpejt e shpejt, e frymëzuar nga kjo e papritur, nga ambienti dhe nga zjarri, me të cilin vendasit i tregonin këto, shkroi një vjershë...

...Kurse unë, siç e thashë, ngeca në vend. Mendova për ditët që po më iknin dhe s'po i bija në të. Atëhere, shqetësimin tim ua tregova shokëve. Disa prej tyre më dëgjuan me seriozitet, disa nënqeshën lehtë, pati dhe ndonjë që më ironizoi, kurse, si moravesh më vonë, pati edhe një, i cili u tall pas shpine. Ndërsa një shok më tha:

— Ja, shih Riza Shinin, ti e ke të zotin e shtëpisë ku po rri dhe s'të shkon mendja fare?

Rizai ishte një plak nja shtatëdhjetë vejç, i ci li ishte dekoruar ato ditë nga Kuvendi Popullor si punëtor i dalluar i kooperativës. Unë e pyeta pér këtë. Ai m'u përgjegj shkurt, ashtu si e kanë zakon ata që punojnë shumë e pér vete s'flasin fare.

Mirë, në rregull, po pastaj? Tregim me pesë rresshta? Kujt i duhet një tregim i tillë? Më vinte turp dhe zor. Kisha lënë mësimet pér kaq ditë dhe s'po nxirrja dot asgjë në krye.

Pas darkës së fundit që qëndruam në Dibër, ndërrova metodën e punës. Ja preva shkurt Xha Rizait: «Natë përnatë të kemi recitar poezi, të kemi lexuar tregime, mbasë edhe të kemi mërzitur, por sonte, xha Riza, unë prej teje dua një tregim...»

— Tregim? Nga unë? Po ku di unë, moj bijë...

— Na folë pér të kaluarën tënde.

Me të thënë këtë fjalë, xha Rizai u pre. Uli kryet dhe diçka mërmëroi nëpër dhëmbë. Por, meqenëse unë ngula këmbë, ai ngriti kryet, më vështroi me dy sy të shqetësuar dhe tha:

— Domethënë, të paskan folur pér të kaluarën time?

— Jo, xha Riza, unë s'di asgjë, prej teje dua të mësoj.

— S'më vjen rëndë të ta them, moj vajzë, zaten unë nuk e fsheh, sepse s'ka si fshihet e vërteta.

— Pér çfarë të vërtete flet, o gjysh?

— Unë, o vajzë... kam qenë i mobilizuar nga ballistët!

Ne të dyja me shoqen hapëm sytë katërsh...

«Xha Rizai! Me ballistët!»

— Po. Ne asaj kohe ishim të paditur dhe skllëvër e bajraktarëve. Ja, tutje, përtej fushës së Pesh-

kopisë, ku duken akoma ato kullat. Njëra është e Kaloshëve, tjetra e Dinëve, tjetra e Muharremit dhe e dreqit me të birin.

Na kishini mbledhur Kaloshët, na kishin futur në një hordhi, pushkët krahut, shgabonjat në ballë dhe «Vdekje tradhëtarëve e Shqipni e Shqiptarëve». Ç'na thoshin? Na thoshin se tutje asaj Toskërie dhe terma asaj Tropoje, ka plakosur greku e sérbi dhe po na prishin atdhe e fe e vatan e Shqipëri...

Ja kështu, xha Rizai ishte më ballin. Po a e din ni se kush më ka shpëtuar mua? (Ne ngritëm supet dhe u vështruam sy më sy). E si mund ta dini?... Më ka shpëtuar nga turpi dhe nga hataja një vajzë toske.

— Vajzë?

— Po. Ishte a s'ishte tamam në moshën tuaj, po aty afër. Edhe flokët i kishte gështenjë, fytyrë ezmere, e veshur si djale, me pantallonë, me kapele e yll në ballë, e pashme dhe truphedhur, kurse sytë... (Këtu xha Rizai psherëtiu), sytë nuk ja pashë kurrë...

— S'ja pe kurrë?

— Po... E ku e pata fjalën? Po. Te partizanët.

Partizanë kishim edhe ne kësaj nahijes sonë, por unë kurrë s'u kisha parë fytyrën e as u kisha dëgjuar zërin. Veçse zërin e pushkës ua kisha ndi për së largu. Por një ditë, na mbledh Kaloshi, aty në fushë Terzishte. Ishte i veshur e i ngjeshur me rroba oficeri, me çizme italiane, hipur në kalë hergjele, që hidhej e s'përmblahej fare. Kaloshi ishte i shqetësuar fort dhe, me mamuzet, po ja bënte barkun plagë asaj hergjeles së shkretë. Si na mblodhi, na ka bërtitë:

— Oj, burrat e Dibrës, o trimat e mi... tosку.

komunist ka plakosur aty në Fushë Alije e don me na djeg e me na shkretu... do luftojm, o burra, dhe kena me i thy ata qena, spiuj t'Stalinit... gjith armët e tyne e paret po jua ndaj juve nji pér nji... «Shqipni e shqiptarëve, vdekje tradhëtarëve...»

Kur sosëm në Fushë Alije, lufta kishte krisur me kohë. Plumbat na fishkëllonin, era e barutit të djegur kundërmonte hendeqeve. Po dukej sheshit se punët s'ishin ashtu si i donte Kaloshi. Me të mbërritur ne, ra nata, e lufta u pre. U duk puna se të nesërmen do të kërciste pushka përsëri. Komandantët e Kaloshit ishin të egërsuar e s'i merrte gjumi fare. Flitej se ishte vrarë një komandant ballist e, madje, një nga çunat e Kaloshit asaj nate, tuj e shti në dhe. i këndoi një kangë:

*Gjer sa ra Tef Kasani  
Nuk u muer istikami...*

Por Tef Kasani shkoi, edhe istikami po lëkun-dej. ... Pastaj, pastaj ç'ka me të thanë, o goce... pa u hap fare dita, të na lëshohen sipër partizanët, po aq befas e aq furishëm, sa, jo ne që s'e kishim pér zemre Kaloshin, por as edhe nejrëzit e tij, s'arritën të bëhen burra.

Pse ta zgjat? Sa pa ra dielli, ne ishim rob. Kaloshi i madh krisi e iku ku sytë këmbët, disa prej të tijve u kapën edhe ata. Atëhere, o goce, më ka hipë një frikë e më ka pre një shqetësim i madh, sa s'kam gojë me ta kallxue. Thashë se i lashë fëmijët jetimë; mendoja se tanë do t'i shihja ata partizanët egër-sira (si na thoshte Kaloshi), që therin njerëz, që i

mbathin robrit më patkonj nér këmbë e që kanë veç nga një sy në ballë.

Po në të vërtetë, ç'ka pashë? Djem të rinj e këngëtarë e aty-këtu edhe goca partizane... pastaj këta djem e këto goca, fshinin armët, mblidhnin armët e fishekët e lidhnin plagët e të plagosurve. Midis nesh (që ishim nja 300) hynë komandantët partizanë e nisën të pyesnin:

- Ti, sa tokë ke?
- Ti, sa bagëti ke?
- Po ti, sa bujq ke?

Dhe na ndanë dysh. Pasanikët (nja 20 veta gjithsejt) i hoqën tërma e na, fukaranë e të patokët, na mblozhën aty. Prit, i kam folë Rizait atëhere, prit kur të na e lëshojnë me mitraloz tanë e të na shtrijnë të gjithëve...

Atëhere hyri midis nesh një komisar e nis e na flet e na flet. Unë më fort po hapja sytë dhe e dëgjoja. Isha mu afër tij, por s'guxoja ta shihja në fytyrë. E mbaja kryet ulur për tokë si rob.

Ai thoshte:

— Ju, bujqit e patokë, ju, hyzmetçijtë e Kaloshëve, s'jeni robërit tjanë, por jini shokët e vëlle-zërit tanë. Ata ju kanë gënjer, ju kanë futur në këtë valle të poshtër për të ruajtur bairakët e tyre. Flisni, o burra... ç'ka po mendoni?

Askush s'ndihej nga ne. Ishim të hutuar e të çartun mendsh. Kur në atë çast, na kalon përrpara një turmë partizanësh me një tabut ndër duar. Ndoshata se u lodhën, e ulën paksa në tokë për t'u çlodhur, dhe komisari përsëri na ka pyetur:

— Hej, burra... a e dini kush e ka vra këtë gocë?

Ma ngushtë se atë dite s'e kam parë kurrë vreten time. Kishim para syve një partizane të vrarë... na pyesnin kush e kishte vrarë, dhe me domosdo ata që e kishin vra ishim ne... po a e di se ç'domethënë për shqiptarin të vrasë një grua e për më tepër një gocë?

Këtu s'u mbajta më dhe e pashë komisarin drejt e në sy:

— Oj burrë! — i thashë, — turp më të madh për shqiptar nuk ka, lëshoje atë mitraloz dhe na korr të gjithëve, se Dibra s'ka si e lan këtë turp.

— Jo, jo! — briti ai, — ju jeni shokët tanë, ne po luftojmë pér të varfërit e pér të patokët. Sapo të mbarojë lufta, po jua marrim tokën Kaloshëve, bejlerëve e agallarëve e po jua ndajmë juve... por tani kush prej jush po e jep besën e po e jep dorën, le të vijë me ne në luftë kundër kaloshëve e kundër gjermanëve...

Hodha një çap, ju avita e fola:

— Ku me e gjet unë atë dorën tande...

Ja, kështu, unë e gjithë ata robër dhamë besën. Veç pak veta thanë se s'donin të ngatërrroheshin me asnëjë anë e shkuan në shtëpitë e veta.

Komisarin tani e përqafova, por gocën e vrarë s'guxoja ta shihja.

Kështu hymë në brigadën partizane dhe munda t'i njihja pér së afërmi ata djem partizanë... dhe i bëra miq pérjetë... shokë s'munda t'u thosha, se ata ishin jo djemtë, po nipat e mi në moshë.

Shkuam në luftë asaj Kosove e luftuam...

M'u duk se Rizai mbaroi tregimin dhe i fola:

— Po a luftove mirë, o xha Riza?

— Për vete s'mundem me folë, o gocë... Kur hymë në Prizren, komisari na çoi në një shtëpi dhe na tregoi: «Në këtë shtëpi, o shokë, i janë vënë themellet Shqipërisë nga 70 vjet më parë.»

Pastaj më ka hequr mënjanë ai komisari e më tha:

— Dëgjo, Riza. Lufta po mbaron, por pyjeve e maleve akoma sillen kaloshër e bishta të kaloshëve, kurse ne na duhet që ti të shoqërosh deri në Peshkopi shokun Ali... a mundesh... a e merr përsipër ta çosh gjallë e shëndoshë, por shpejt... do të udhëtoni ditë e natë...

— Po, — i thashë...

— Si do ta çosh?

— Kemi një zakon të mirë na: Besën... mik më mik e fshat më fshat.

Dhe u nisëm. Aliu mbante syza në sy, e unë përveç emrit asgjë më shumë s'dija për të. Rrugës, ai më fliste e më tregonte e më mësonte. Ishte shkollar i madh. Pastaj i hipi në kokë e më tha: — Sa të arrijmë në Peshkopi, e do të të mësoj shkrim e lexim.

Unë qeshja, por ai s'm'u nda... dhe shkrimin e leximin, që di sot, prej tij e kam.

Sapo mbërrijtëm në Peshkopi, ballë për ballë na dalin disa partizanë. Këta e njihnin shokun që po shoqëroja, ju lëshuan sipër dhe e puthën e e përqafuan... dhe e nderonin fort, por në vend që ta thërrisin Ali, po e quanin Fahri... unë po hapja sytë...

Pastaj mësova se kështu ishte një zakon e rregull i asaj luftës partizane: Disa nga ata shokë që kishin përgjegjësira të larta në punë të luftës mbanin emra të rremë. I fola partizanit tim:

— Shoku Ali ose Fahri... detyrën e kreva, tani apo më lejon të nisem e të kthehem në brigadë, në Kosovë??

I mbaja kryet ulur, se më vinte vështirë që Fahriu s'më kishte treguar emrin e vërtetë, prandaj ai më përqafoi, më rrahu sup:n, qeshi e më tha:

— Sa vjet je, Riza?

— Pesëdhjetë, — i thashë.

— Mirë, lufta po mbaron. Ti plak s'je, por aty në fshatin tënd kanë nevojë për ty.

— Çfarë nevoje kanë për mua?

— Po, mund t'u duhet një kryetar këshilli i mirë.

— Unë kryetar këshilli?... — dhe e ngrita kryet.

— Pse çuditesh... iku koha e kaloshëve... pastaj së shpejti do të bëjmë reformën agrare.

— Ç'është kjo «agrare»... se unë s'para i di këto...

— Po litarin e gjatë a e di?

— Si të të them...

— Pra, e merr Rizai me shokë atë litarin dhe tokën e kaloshëve jua ndan bujqve pa tokë. Kështu. Unë tani po shkruaj një letër për shërbimin tënd si partizan. Dhe Fahriu e shkroi letrën...

Përsëri m'u duk se xha Rizai e mbaroi tregimin e tij, dhe e pyeta:

— Xha Riza! Po çfarë shkroi Fahriu në letër?

Axha Rizai s'foli, po plaka e tij aty në qoshe, te vatra, ajo që gjer atëhere s'kishte ndjerë fare, ngri-ti dorën dhe tregoi një kornizë varur në mur. Unë kërceva dhe e mora kornizën ndër duar. Atje lexova:

«Partizanit nga Dibra, shokut Riza Shini, që ka luftuar si trim në radhët partizane.»

## ZEMËRIM DHE ... PAFAJËSI

Atë ditë, ai s'hëngri as mëngjez. U vesh shpejt e shpejt dhe vajti të firmonte fletëlejen te komandanfi. Këtë e gjeti në zyrë. Rrinte duke pirë cigare e sapo e pa të hynte, u ngrit dhe i tregoi karrigen.

— Ulu. Do të shkosh, hë?

— Do të shkoj.

— Të ka marrë malli, ë?

— Si të të them? Më ka marrë, si s'më ka marrë. Vetëm një herë kam shkuar gjatë tetëmbëdhjetë muajve.

Komandanti e vërente me kujdes që nga tavolina e tij.

«Është djalë i mirë, shejtani. Po duket i egër. . .»  
Dhe aty pér aty, shtoi:

— Me se do të udhëtosh?

— Me maqinë të rastit.

— E di ç'ke ti, Vasil?

— Hë?

— Më prit. Do të vij edhe unë andej nga Jugu. Ka kohë që s'e kam parë xhaxhanë. U plak tani. Ti besoj e njeh.

— Xha Nasin? Si s'e njoh? Është orëndreqës i zoti ai.

Ata udhëtonin në një maqinë të hapur. Lart, në karroceri, kishte pak njerëz: ushtari, komandanti i tij, dy pleq dhe tri gra, njëra prej të cilave mbante në gji një fëmijë të vogël.

Ushtari fërshëllente një motiv të njohur. Kish te ngritur jakën dhe kapelen e kishte vënë në rrip që të mos ja rrëmbente era. «Sa më ka marrë malli. Sa të arrij. S'po më durohet sa të arrij. Nëna as që më pret fare. Këta ma dhanë lejen papritur. Sa do të gjëzohet nëna. Po Mimi? Ajo çdo ditë më pret. I duket sikur do të hap derën në çast, do t'i zë sytë e do të pres të më njohë. Oh, ajo m'i njeh duart. I kam të ashpra nga tornua.

Ai buzëqeshi i lumtur nga ai ëndërrim me sy hapur. «Sa të zgres, do të shkoj te Mimi. Mimi patjetër do të jetë në librari. Sytë i ka nga maqinat. I vëren ushtarët me kujdes. I duket sikur papritur do të më shohë mua... Pastaj do të shkoj në shtëpi. Sa të hap derën, do të shoh lulet në oborr. Do të mbyssë si gjithnjë era e borzilokut, që e mbjell nëna anës leheve... Në hajat do të jetë po ai zhezlong i vjetër, ku mbështetet babai mbasditeve. Dhe macja do të jetë aty, te leha e luleve, duke u ngrohur në diell. Sina do të jetë kthyer nga puna e patjetër lan enët e drekës. Ndërsa nëna, nëna me siguri pastron nga pluhuri kostumin tim. Kushedi sa herë e ka pastruar deri tani. Aty te rruga do të më shohin kalamajtë e lagjes e do të vrapijnë kush e kush më parë për t'i dhënë lajmin nënës. Deri sa të arrijë nëna te porta, kushedi sa herë do të jetë rrëzuar...»

— Hej, zbrit, arritëm.

Atij ju duk sikur u zgjua nga një gjumë i rëndë. Mendoi: «Ku isha kështu» Dhe instinktivish u hodh nga maqina. E toku me komandantin dhe fluturoi, duke kënduar atë motivin e njohur.

«Kush e shtyn të fluturojë  
Do ta gjej nga shkrimi i saj...»

Kur arriti në shtëpi, derën e gjjeti hapur. Nuk doli ta priste asnjeri. Ishte po ai shezlong i vjetër, ku mbështetej babai, po ato lule në oborr, përqark të cilave kundërmonte borziloku... vetëm kudo ishte qetësi, thua se në shtëpi nuk do të kish asnjeri. Sa u afrua te dera e dhomës, ju bë se dëgjoi zëra burrash e më pastaj një të qarë fëmije. Ai e shtyu derën ngadalë. Shtangu në vend. Ballë për ballë ai pa komandantin e tij, në krah të këtij ishte babai, më poshtë sekretari i partisë së lagjes, ai Petrua, me të cilin dikur ishte zënë për një çështje pune.

Në moment, s'arriti ta mblidhte dot veten.

«Nëna — mendoi. Mos i ka ndodhur gjë? Prandaj më shoqëroi komandanti. Më gënjeu, duke thënë se do të shihje xhaxhanë?

Po nëna doli në çast nga kuzhina e ju var në qafë. I lëmoi flokët dhe ballin me dhembshuri, dhe ai psherëtiu i lehtësuar.

«Po ç'janë gjithë këta burra këtu? Ç'të ketë ndodhur vallë? Ai hyri në dhomë. Babai i zgjati duart dhe e përqafoi, komandanti i tij i buzëqeshi pak hidhur, ai Petrua, sekretari, i rrahu supin, ndërsa Sina, ajo motra e tij çapkëne, rrinte e heshtur, kokulur dhe dridhej. Ngriti sytë. I rodhën lotët tatëpjetë faqeve. Ishte e zbetë. Dhe s'ju afrua. Poshtë në dysheme, mbi qilim, zvarritej një fëmijë i vogël rrëth

5-6 muajsh, që, porsa pa të huajin që hyri në dhomë, vuri të dy duart e vockëla mbi faqe e nisi të guitte tërë gaz...

Vasili u drodh. Akoma s'po kuptonte ç'ngjiste në shtëpi: «Komandanti i tij, Petrua, babai, nëna, Sina... dhe ky fëmijë...».

— Ç'është, pra, ç'ka ndodhur?

Ai edhe vetë u tremb nga zëri i tij. Ata të gjithë vështruan njëri-tjetrin dhe heshtën, sikur kjo heshtja e tyre t'u thoshte mysafirëve: «E, a s'ju thamë? Ai është gjaknxehtë.»

Ai u ul në kanape. Shkopsiti kopsën e gjimnastjorkës dhe shkoi dorën e dirsur poshtë zverkut.

— Vasil, — dëgjoi ai një zë. U lkthyte. Po fliste babai. — Këto gjëra ndodhin në jetë. Në fund të fundit, ajo është bija jonë. . . . ne s'mund ta mohojmë. . . .

— Sina! A është e mundur? Jo, jo. Thoni që është gënjeshtër.

Që poshtë mbi qilim e vështronin sytë e habitur të fëmijës.

Sina heshtte, e mbështetur pas dollapit të rrobaive. Kapérthente gishtat e duarve me njëri-tjetrin dhe dridhej. Ajo e njinte mirë Vasili. Ai gjithmonë kishte qenë i egër me të. Kurre s'e kishte lënë të delte vetëm.

«Po pse ndodhi pikërisht tani? Pse? Le të ndodhte të paktën kur të qe ai këtu. Ai do ta marrë këtë si një dobësi timen. Do të kujtojë se ai më ruante, se sa isha me të, s'më gjeti gjë. Po unë, «atë» e dcja që kur ishte Vasili këtu. Ky s'kishte si më ruant. . . »

— Vasil, tani ndodhi kjo!

— Dhe ju ma keni mbajtur fshehur për kaq kohë?

— Nuk deshëm të të alarmonim... pastaj... Sina ka hequr shumë... ja, sa ka që e mori veten...

— Kush është ai?

— ...

— Flisni, pra, kush?

— S'ka rëndësi ta dish. Ai ishte... tani nuk është më, desha të them... për mua, s'është më.

— Sikur ta dija kush është, ah, sikur ta dija...!!

— Vasil, ti je i shqetësuar. Kjo të doli fare prpritur. Po duhet përballuar. Ajo i besoi. Ai kishte qëlluar njeri i dobët, pa karakter... .

Petrua fliste ngadalë. Nuk desh ta lëndonte më shumë atë. Pastaj, e njihte mirë Vason, që merrete zjarr shpejt. Prandaj pleqtë e kishin thirrur aty, me gjithëse Sina nuk kishte dashur... Pastaj, se mos kishte qenë më e lehtë kjo për prindërit! Ata e dinin se si e kishin mbajtur veten. Ata dhe Sina. Vetëm para pak ditësh ata i kishin shkruar letër komandanit të tij për këtë... duke shtuar që, mundësisht, ta shqëronte njeri... se ku dihej... në inat e sipër...

...Mbase Sina akoma i ndjen të nxehtha pëllëmbët e babait në fytyrë. Mbase akoma i buçasin veshët nga ato pëshpërimat ngjethëse të njerëzve të lagjes: «Pupu, i turpëroi!»

E tani hesht. Hesht para Vasos e mundohet të shohë fëmijën e saj, që rrrokulliset duke tundur ndër duar një rraketake të bukur e gjithë ngjyra.

Dhe Vasua hesht. Ka vënë kokën mes pëllëm-bëve dhe hesht. Ai e ka të vështirë ta përmbjë veten. Nuk e beson atë që ka ndodhur. I duket si nëëndërr. Tani do t'i duhet të gëlltitë atë turp e të mba-

jë në shtëpi të tij një foshnjë të një të huaji, të një tjetri, që mbështetet i panjohur.

Komandanti u ngrit. Kërkoi ndjesë dhe doli. Te dera u kthye prapë dhe e toku me Vason:

— Vaso, ti je djalë i thjeshtë, punëtor. Duhet ta kuptosh. Jeta i ka këto...

Vasua s'dëgjoi më. Mbylli derën e u kthye përsëri në dhomë. E përsëri ndeshi në atë gjitjen tërë gaz të fëmijës. Pastaj vështroi nga e motra. Ajo rrin-te po aty, te dollapi i rrobave...

«Qenka zbukuruar!» — Vuri re me vete.

«E mban veten, — mendoi babai. — Si duket i vjen turp nga Petrua. Kur të ikë ai, kushedi se si do të bëhet.»

— E pse nuk martoheni? Në qoftë se ai s'do, detyroje. Ai është babai i fëmijës...

— Vasil!

— Vasil, Vasil! — e përqeshi ai. — Jo, po... do të mbajmë edhe... (desh të thoshte një fjalë të rën-dë, po e mbajti veten) edhe fëmijët e botës këtu.

— Mos, Vasil! Ai nuk është i botës. Është imi.

— Yti? E di që është yti, po nuk di se i kujt tjetër është.

— Ta thashë, pra, s'ka rëndësi.

— Si! Pa përsërите edhe një herë!

Ai u mat ta godiste. Ndjente prapë atë supërioritetin e vëllait mbi motrën. Sina e pa qetë, pa ju dridhur as qepalla. Çudi! Ishte e qetë. Kjo qetësi mos vallë i vinte nga dëshpërimi i saj për dashurinë e humbur... ndoshta nga dridhja e zemrës të s'ëmës për fatin e saj, nga rrudhat e thella në ballin e babaït plak... mos vallë nga grishja për të jetuar edhe kështu... mos nga ajo gjitja tërë gaz e asaj foshnje-

ze të bukur... apo mos nga ndjenja eëmbël e mëmësisë, që i bën gratë më zemërgjera? Ku dihet!

Sina e kaloi atë provën e parë edhe me të vëllanë. Tani sikur u mësua.

Ajo u afrua te fëmija. E kapi me gishta të dridhur te mjekra dhe e bëri të qeshte. Pastaj e vuri mbi divan, aty ku rrinte dhe Vasili, që sapo kishte ulur grushtin e tij të rëndë. Ai e vështronte me bisht të syrit. Në atë çast zemërimi, i ardhí neveri për Sinën... edhe për atë foshnjëzë të pafajshme.

Kishte tani vetëm një dëshirë: Të kishte ta njihet atë njeri, gjaku i të cilit lëvrinte në dejtë e kësaj qënjeje, që zvarritej aty, pranë tij.

Ata të gjithë heshtnin. Vetëm fëmija zvarritej nëpër divan e bënte një zhurmë të lehtë me rraketaken e tij, me të cilën kruante mishrat e dhëmbëve. Sina fshinte filxhanët e kafesë, që sapo i lau nëna. Petrua e babi nisën një bisedë për motin, ndërsa ai, Vasili, shtrëngonte grushtat, i zëmëruar. I dukej tani sikur asnjeri s'po e përfillte në atë shtëpi.

— Nënë, nxirrma çantën e shpinës. Do të iki.

— Vasil!

— Do të iki, thashë. Unë s'e duroj dot këtë turp.

Ata të gjithë heshtnin përsëri. Vasili e dinte se ata ja ndjenin sedrën e sëmurë. Dhe Sina që kishte menduar për një çast se do ta kishte përkrahjen më të fuqishme!

Ai rrinte i pështetur pas pervazit të dritäres. Në një çast, fëmija, duke u zvarritur, kishte arritur në buzë të divanit. Sina e pa dhe klithi. Edhe pak e do të binte! Edhe pak! Vasili u kthye. E zuri foshnjën me shpejtësi dhe e vuri përsëri në divan. Ndjeu

një dridhje të lehtë nga prekja e atij kurmi të njo-më...

E papritur ju duk sikur vezulloi ai loti i fshehtë i Sinës mbi dy mollëzat e skuqura të faqeve të saja...

## «SHOQJA» PARE

Në ndërmarrjen e shërbimeve, ku kam punuar vetë, kishte lloj-lloj tipash. Njerëz të punës dhe gazzmori, me pak shkollë dhe me shumë humor. Kishte artizanë nga më të ndryshmit, që zakonisht mbanin syza pleqërie me rrathë prej teli, me ballë të rru-dhur dhe me duar të shkathëta, për të cilët thuhej se «çfarë u sheh syri, u bën dora»; kishim pastaj fshesarë e fshsare, karrocaxhinj e kovaçë, teknikë dhe inxhinierë dhe, në fund të fundit, medoemos, kishim edhe nëpunës. Por nga e gjithë kjo turmë njerëzish që punonin dhe i shërbenin qytetit, unë s'kam për të harruar Paren. Nuk e di se si e kishte emrin e plotë, por ne të gjithë e thërrisin Pare, ose më saktë, shoqja Pare. Në rastin kur mungonte fjala «shoqja» përpara emrit dhe ishte atje prezent vetë shoqja Pare, atëherë ajo ta shkrepte:

— Me tët motër flet, apo me tët vëlla?

— Pra, shoqja Pare.

Ishët kjo një grua e shkurtër dhe tepër e ngathtët. Zyra e saj ishë e siguruar fort me hekura në dyer dhe në dritare, brenda kthinës së zyrës së saj ishë edhe një kafaz tjetër prej hekuri dhe, të them

të drejtën, unë se kisha parë kurrë të hapur dritaren e vetme të zyrës së shoqes Pare. Në zyrën e shoqes Pare vinte era myk dhe pluhur, merimangat kishin atje foletë e tyre, që i numëroje fare lehtë sapo hapte gojën e fliste shoqja Pare, sepse të gjitha fratzat e saja ishin mendime të një mendjeje gjumashe. Të habiteshe e patjetër do të hidhje vështrimin e do të shihje në të katër qoshet e tavanit të shoqes Pare. Shoqja Pare, përveç çorapeve edhe disa lloj kallcesh në gjunjët, vishej trashë e rëndë dhe patjetër të kujtonte ata lojtarët e hokeit mbi akull. Edhe defterët e zyrës së saj ishin tepër të butë dhe mbanin erë myk. Sikur një gërmë të shkruaje mbi to, boja përhapej dhe merrte disa forma të shëmtuara. Shoqja Pare nga ky shkak e përdorte shumë jo aq kartëpirësen sesa hirin e mangallit të vet.

Unë nuk mund të them se marrëdhënjet e shoqes Pare me njerëzit tanë të punës ishin shumë të këqia, por mund të them se te ne njerëzit nuk e shihnin atë as me dashuri e as me mirëdashje, por me njëfare druajtje. Sa herë, që ndokush vinte ballë përballë me shoqen Pare, i tkurrte për një çast kapakët e syve, mblidhte edhe hundët apo buzët, sikur do ta sulmonte ndonjë erë jo fort e këndshme.

Njëherë, shoqja Pare arди në kundërshtim me të gjithë kolektivin. Ishin orët e një mbledhjeje te-për të nxeh të. Shoqja Pare, në atë mbledhje, u ngrit dhe foli kundër rrobaqpëses sonë të re, Dritës, e cila kërkonte të shkonte për studime të larta.

— Ju lutem shumë! — thërriste ajo. — Këto punë i di unë më mirë se kushdo tjetër, ju lutem shumë. Drita ka një pikë të dobët në «biografi».

Kur Drita u nis për në institut, doli i gjithë kolektivi për ta përcjellë, me përjashtim të shoqes Pare, që u shti e sëmure. Por, edhe kur u kthyte në zyrë, shoqja Pare e tha mendimin e saj: «Dritës ju dha e drejta e studimit «me ndërhyrje». Edhe atje në rrreth ka njerëz që nuk e kanë të mprehtë vigjilençen revolucionare. Unë do ta ndjek çështjen deri në fund, pa do t'i shkruaj letër personale vetë ministrit të arësimit. . . . në mos më lart.»

Këto fjalë nuk u hodhën dosido. Këto fjalë shoqja Pare i tha mu në mes të oborrit të madh të ndërmarrjes sonë, atë mëngjez kur sapo u kthyte në punë, në atë kohë kur nisen për në rrugët e qytetit ato karrocat e shërbimit që mbledhin plehrat. Askush nuk i foli shoqes Pare. Mbase njerëzit mendonin se do të ishte një humbje kohe e kotë. Por njëri nga karrrocaxhijt tanë, një djalosh ezmer, që e quanin Osman, në çastet kur fliste shoqja Pare, u ndodh me frerin e kalit nér duar, me atë frerin prej rripash që ka për anash dy si pulla të trasha prej meshini. Dhe Osman, gjoja sikur harroi, me frerin e ngritur lart, nuk mori të shkonte drejt kalit të vet, por drejt shoqes Pare.

Në sheshin e ndërmarrjes sonë plasi e qeshura, dhe këmbët e shkurtëra të shoqes Pare u drodhën aq fort, sa unë vura re se kallçinat e leshta, që ajo mbante nér gjunjë, i ranë pak më poshtë.

Shoqja Pare nuk e kuptoi gjer në fund shakanë e Osmanit, por nga e qeshura e punonjësve tanë, ajo kuptoi se diçka po thoshin për të. Shkoi në zyrë gjithë inat, mbylli nga brenda derën e saj të hekurt dhe, duke mos ditur ç'të bënte, hapi librin. Nuk ishte e dhënë pas leximit shoqja Pare, por, sado e pa-

għħendur, ajo kishte nuhatur se medoemos duhet tē lexonte disa libra (zgħidha għithnej libra me ka-pakē tē kuq, pa ju bérē vonē pér pērmbajtjen, e happe librin diku nga mesi, merrte lapsin nē duar, sikur do tē mbante shénime, vinte njérin mbi tjetrin ato għunjiet e trashé mē kallċa tē leshta. Ky ishte qəndrimi saj i preferuar. O, sikur nē ato ġaste tē vinte dhe ta' gjente njeri duke studjuar!

Duhet pērmendur se ato kallċinat e trasha, Parja i thurrte vetē, me fije copa-copa, tē shqepura prej fanellash tē vjetra, tē cilat, edhe atō, mbanin erë myk dhe djers... .

Unē atēhher luaja basketball me skuadrën e vajzave qē qytetit tonē, dhe ikjet e mia tē shpeshta nér qytete tē tjera e tērbonin shoqen Pare nē kulm. Pērballé qđo arësyetimi, ajo vinte frazat e saja tashmē tē njohura nē tē għiġi ndērmarrjen:

— «Dakord, dakord», aktivitet sportiv, por **ata tē** sportit nuk firmojnē pér vērtetim nē borderonē tēnde, kētu firmoj unē dhe mua mē vret ndērgjegija... posī, posī, ku ta' di unē se si e shfrytēzon ti kohēn? Shkon nē praktikē, apo «grumbulloħesh», apo ikēn nē Tiranē, ku ta' di unē?

— Shoqja Pare, ja ktheja unē, ti duhet ta' kesh pér nder qē njē punonjés yt shkon dhe bēn qmos pér tē nderuar qytetin e vet dhe...

— Aaa, vajzē, kēto konferenza nuk mē duhen mua!

— Po e di ti se unē i djeg tē gjitha tē dielat pér interesin e pērgjithshēm, pér sportin, pér kulturēn...

— Nga qejfi i djeg, kush tē detyron?

Njē ditē prej ditēsh, Parja e mbushi kupēn dhe,

kur askush nga ne të ndërmarrjes nuk e pandehte, doli fjala: «Shoqja Pare u transferua nga ndërmarrja jonë.»

Natyrisht, ky lajmë më gjëzoi gjer në atë çastin kur nuk e kisha marrë vesh vendin ku ishte dërguar ajo për të punuar. Dhe, kur u tha se shoqja Pare ishte caktuar si magaziniere në stadiumin e qytetit, mua sa s'më ra pikë.

Karrocaxhiu ezmer, ai Osman i djallush, sa më ardhni në zyrë për të më dërguar kuponat, ma plasi:

— Liljana. Më s't'u nda rrodhja ty.

Shoqja Parje ardhni në stadium dhe mori në dorëzim magazinën nga Haxhiu, i cili delte në pension. Plaku, tek dorëzonte materialet, dridhej, dhe shoqja Pare, përbollë një gjendjeje të tillë, u trembësë tepërmë. Ajo mendoi se Haxhiu nuk do të ishte në rregull me inventarin. Dhe dorëzimet, nga tri ditë, zgjatën tetë ditë.

Duke u larguar nga magazina, Haxhiu qau me lot përfaqe, na puthi një për një të gjithëve, që nga vajzat e basketbollit dhe gjer te rezervat e skuadrës së futbollit, kurse shoqja Pare i tha:

— Sidoqoftë, shoku Haxhi, unë firmova me rezervë, topat m'i dorëzove të përdorur, kurse ata figuronin si të rinj.

Sapo filloi nga puna, shoqja Pare, ja nisi nga të sajat. E dëgjova kur i ankohej shefit të arësimit dhe kulturës.

— Ju lutem shumë, shoku shef, kur është derdhur gjithë ky beton dhe ky hekur për stadiumin, pse është kursyer për disa shufra hekuri për de-

pon?... unë s'mbaj depo pa kyçe të sakta, pa heku-  
ra në dritaret, pa dyer të siguruara, pa...

Ata që ishin pas shefit u kthyen dhe e panë atë  
grua me sytë si gunga, me fytyrën anemike, me ata  
gjunjët e trashë, që të kujtonin lojtarët e hokeit mbi  
akull. Dhe, sa herë vinte shefi i sektionit apo ndonjë  
shok tjetër, shoqja Pare, nuk linte rast:

— Rrjetat, shoku shef, i copëtuan, shoku shef;  
praktika të bëhet pa rrjeta, shoku shef. Edhe topat  
u dërmuan, shoku shef... kurse ajo Liljana, ju beto-  
hem, për ideal, shoku shef, ajo Liljana e bën për ina-  
tin tim. Kur unë ndjek me sy lojën e saj, ajo më sheh  
me bishtin e syrit dhe përplaset ku mund e si mund,  
i copëtoi teshat, shoku shef, ju them për nder e për  
ideal, shoku shef.

— Po a e njeh ti shoqja Pare shoqen Liljana?  
Ajo...

— E si nuk e njoh unë, shoku shef, e kam pasur  
në ndërmarrje, i njoh dhëmbë e dhëmballë, shoku  
shef, atje ajo s'ka qenë hiç e rregullt dhe pastaj...  
do ta thosha, por përbën një sekret shtetëror...

Shefi arësimit zgurdulloi sytë:

— Sekret shtetëror?

— Po, po, po eja mënjanë, shoku shef, se s'bën  
të na dëgjojnë... kushërrira e saj shkoi për studime  
të larta me ndërhyrje.

— Ti po flet përqart, shoqja Pare, unë jam vetë  
në komisionin e shqyrtimeve, unë jam shef i arësimit.

— Po dale, shoku shef, ti je shef i sportit, jo i...

— Dëgjo, Pare, ti shih punën tënde, mos u nga-  
tërho në punë që s'të takojnë...

E pakënaqur ngaqë ja zunë emrin në gojë pa atë «shoqe» përpara, Parja u zemërua, po ajo kishte vendosur t'i shkonte bisedës gjer në fund.

— E s'i s'më takojnë, shoku shef, a s'jam qytetare unë, a nuk është vigjilencia revolucionare për të gjithë qytetarët?

— Dëgjo, Pare, këto s'janë punët e tua, ti, a ke ndonjë fjalë përsa i përket punës sate në magazinë?

— Po si nuk kam, shoku shef, kam edhe shumë, bile. Se mos e humbas kohën kot unë? Kam disa propozime, shoku shef.

— Pa t'i dëgjojmë...

Shoqja Pare fërkoi me gjuhë buzët e saja të verdha dhe, duke ruajtur me sy vështrimin e shokut shef, ngriti më lart kallçinat prej leshi, që i qenë zhubrosur mbi gjunjët, dhe ja filloj:

— Vijat e bardha në stadium të mos shënohen më gëlqere, shoku shef, gëlqerja kushton shumë dhe është mall defiqitar, nevojitet për ndërtimet, në vend të gëlqeres së bardhë propozoj t'i shënojmë vijat me qymyr të zi, prej atij të djegurit...

Shefi u përmbajt që të mos queshte.

— Tjetër, Pare...

— Ja, mendoj, shoku shef, ndeshjet të mos bëhen të dielave, pse të punojmë të dielave ne. Ndeshet të bëhen të shtunave pasdite, pse ne t'i djegim të dielat kot?

— Po mirë, Pare, po ata djemtë e vajzat që lozin vetë? Po spektatorët, që vijnë me aq entuziazëm në stadium?

— Ohu, po ata janë të rinj, shoku shef, ata ja

kanë ngenë, ata e bëjnë për qejf, kurse neve partia e pushteti na kanë siguruar ditën e pushimit. Sido-qoftë, unë të thashë mendimin tim dhe respektova shkallën hierarqike, pérndryshe do t'i drejtohem Ministrisë, shoku shef, të më falni, po... jam e de-tyruar, shoku shef, s'më lë ndërgjegjja të hesht, shoku shef...

Kjo ndërgjegjja e shoqes Pare! Përpélitej si midis dy zjarreve, në mes interesit të përgjithshëm dhe atij personal, po s'digjej veç për shoqen Pare.

## LETËR

Ajo u zgjua menjëherë sapo ra zilja e portës e sapo dëgjoi zërin e njohur: «Posta, Luljeta.»

Te shkallët, e ëma i dha letrën, duke u munduar t'ja vështronë sytë që nga poshtë... por Luljeta nuk ja dha sytë nënës. E mori letrën dhe u mbyll në dhomën e saj. Atje e hapi dhe lexoi me buzët të shtrënguara. Flokët e shpupurisur i vare-shin mbi ftyrë dhe i ngacmonin pushin e butë të gushës.

«Pra, këtë letër e ka shkruar ai... njeriu që aq shumë ë kam dashur, që më betohej se më donte, po ashtu si e desha edhe unë.»

Ajo e lëshoi letrën mbi tryezë dhe ju kujtuan vargjet e një poezie që e kishte lexuar dikur: «I mora tëmblat në duar...»

Luljeta u mundua të kujtonte vargun e dytë, por ju kujtua i treti a i katërti, diçka si nëpër mje-gull...» Ishte një kandil më të mbaruar... «Për të pritur prapë mëngjeze...»

Pastaj ajo psherëtiu dhe mendoi përsëri: «Pra, këtë letër e ka shkruar dhe e ka nisur ai...»

Që poshtë ndiheshin zhurmat e shtëpisë. Mama-

ja gatiste bukën e saj pér në punë, vëllai i vogël që llonte me çekiç një peronë të vogël në këpucë, pastaj përsëri zëri i mamasë, që i thoshte babait: Luljeta edhe këtë javë ka turnin e dytë...

Luljeta vuri dorën në mjekër dhe humbi në kujtime...

«Ishte natë. Ne ecnim të dy nën akacjet, ashtu sikurse ecnin edhe çifte të tjera. Dëgjohej zhurma e Tiranës, dhe dritat, feksnit të panumërtë. Ne ngjitheshim kodrës gjithnjë e më lart, e qyteti sikur zbreste më poshtë. Dëgjuam gurgullimiën e një çezme, pastaj llapashitjet e liqenit... dy ushtarë nxitonin nëpër rrugë, çapet e tyre ndiheshin nëpër natë, kurse te veshi im vinin ato pëshpëritje, që i kisha dëgjuar kushedi sa herë, po që më pëlqente t'i dëgjoja përsëri. **U ulëm te froni, afër bregut të liqenit.** Nata ishte e freskët. Ajri ishte i lehtë dhe si i shkuar nëpër bisqet e shelgjeve lotues.

Unë u struka mbas krahërorit të tij të gjerë e ndjeja mbi fytyrë afshin e frysës së tij. Nën këmbët tonë kërcisinin lehtë gjethet e thata të akacjeve...

E vështroja atë, sikur do ta përpija me sy, ndjeja një turbullim të ëmbël e dehës në tërë qënjen timë. Desha ato çaste t'i pëshpërisja mijëra fjalë, t'i thosha sesa shumë e doja, t'ja përkëdhelja lehtë tëmthat, t'i ngatërhoja gishtërinjtë e mi nëpër flokët e tij të butë... por s'guxoja, më vinte turp....

Rrinim, ashtu në heshtje, duke dëgjuar zhurmat e liqenit, fëshfërimën e fletëve. që binin, dhe frysëmarrjet tonë... por... fare papritur... një fëshfërimë fustani, dhe një vajzë e panjohur, e nxituar e gati e egër, ardhë e u ul në fron.

U prapsa... një vajzë e panjohur. U ul pas tij,

dhe ai u gjend kështu midis dy vajzash... dhe menjëherë një gjilpërë sikur më shpoi në tru. Unë as e njihja atë vajzë as më njihte, kurse ajo dhe ai nji-heshim midis tyre...

Por s'munda të mendoja më shumë, sepse vajza e panjohur, me një zë të dridhur, m'u drejtua mua:

— Më fal, kjo ndoshta s'është e hijshme, por unë s'munda më... këto që po dëgjon ti sonte, unë i kam dëgjuar qindra herë po prej këtij njeriu... madje edhe mbrëmë i dëgjova...

Ajo psherëtiu thellë. Nëpër dritën e hënës pa-shë se si i vezulluan dy lot të vegjël nën qepallat e gjata. Ajo dridhej. Desha ta qetësoja, t'ja fshija ato lot, por zëri saj, për çudi, tanë m'u duk më i vendosur. Po lotët? Pse qante për atë? Ndoshta nga e parpritura? Ndoshta ngaqë pësoi zhgënjim? Apo ndoshta ngaqë e donte prapë?

— Ja edhe tufa e letrave... me siguri letra të tillë do të kesh edhe ti... ka një aftësi, që s'e kanë të gjithë: të magjeps me letrat e tija. . ja stoli ynë... ja stoli im...

Pastaj ju drejtua atij:

— A e di emrin që të takon, apo të ta thim unë? S'po u besoja syve. S'po u besoja veshëve. M'u duk sikur shihja ëndërr. Ai heshtte. Pastaj u drodh. S'mundi të fliste.

S'dëgjohej asgjë veç frymëmarrjes së shpejtë të asaç vajze të panjohur, s'dukej asgjë veç syve të saj, që gati lëshonin xixa. Kurse unë e humba fillin, e humba torruan, më hipi një dridhmë e fortë, s'di pse më ardhhi trazi dhe u çova. E panjohura më kishte hedhur dorën në sup e po më ftonte të bëhesha shoqja apo motra e saj. Kapa gishtat e asaj dore në supin

tim dhe kuptova se ajo dora ishte e një vajze punëtore. E ashpër si dora ime. . .

Ai kishte ulur kryet e s'po ndihej.

— Eja të ikim! — më tha ajo dhe më tërhoqi fort. Ne ikëm. Shoqja guxoi dhe e pështyu atë, kurse unë s'pata guxim të bëja asgjë. Zaten, përherë mua më ka munguar guximi. . . Por sonte, befasia, e papritura më kishte paralizuar të gjitha pjesët e trupit. Nisën të më merreshin mendtë, të më merreshin këmbët, të më buçisnin veshët, fillova të shihja anembanë e përsëri më dukej vetja në ëndërr.

Tani, nëpër dritat e mekura të qytetit, që vinin gjer këtej, nëpër degët e rënda të shelgjeve lotuese, vështroja shoqen time. Ajo dukej zeshkane. Ishte pak më e shkurtër se unë, por më e plotë.

— Intelektuali, studenti, — shpërtheu ajo. — Në fillim. . . sa i pérulur. . . më priste udhën kur delja nga uzina. . . po ti ku punon?

— Në profarma.

— C'punë bën?

— Mbush ampula. . .

Ajo po më tërhiqte gjithnjë nëpër udhëzën e agushtë e të asfaltuar, që zbriste në qytet.

— Pa dale? — munda dhe i belbëzova. — ku po na çon kështu?

— Në fakultetin e tij.

— Po është natë, atje. . .

— Kanë mbrëmje vallëzimi, janë atje të gjithë ata që duhet të jenë.

— Po. . .

— Rrugës t'i shpjegoj të gjitha.

\* \* \*

Pas tri ditësh më thirrën në fakultetin e tij. Më priti një grua e panjohur. Në moshë ishte nëna ime dhe... si nënë më foli. Dhe këtu pata rastin të takoja për të dytën herë shoqen që e pata njohur vetëm nëpër natë.

Që prej asaj dite, «atë» e përjashtuan nga fakulteti. Dhe hyri në punë...

...dhe sot, pas dy muajve, ai po më shkruan. Po vallë vetëm mua? Mos i ka shkruar edhe asaj po këto fjälë? Nuk e besoj. Sidoqoftë, një xixë xhelozie më mundon dhe s'di përse kjo më duket e çuditshme dhe e pabesueshme, por në të vërtetë kështu po më ndodh. E habitshme, por këtë xixë xhelozie po e ndjej.

Ajo që ka menduar ai duhet të jetë kjo:

«Luljeta është më sentimentale. Vali është më e rrëmbyer dhe më e ashpër. Luljetën mund ta thyej, madje, po më shpëtoi nga e keqja... edhe mund të martohem me të...»

Po sidoqoftë, ai më shkroi vetëm mua... «apo e filloj me radhë... të trokasë portë më portë...»

Luljeta përsëri kaloi sytë mbi letrën e tij dhe lexoi:

«Është e rëndë për mua të të shkruaj pas asaj që ndodhi. Dhe që të shkruaj, ti e kupton «psenë»: Jam penduar. Po të më vijë një letër me falje nga ti... ti s'mund të jesh aq mizore sa të ma refuzosh këtë... madje, të premtoj se pas letrës sate, unë jam gati të shkoj me ty edhe në gjendjen civile... që atë ditë...»

«Si nuk i vjen turp.»

Luljetës ju duk se te veshi i saj i ardhi edhe zëri i tij, bashkë me atë mënyrën e nxituar, me të cilën ai fliste. Ajo u rrënqeth dhe kafshoi buzët me inat:

«Ai gënjen, gënjen, gënjen.»

Por, sidoqoftë, ajo duhej t'i përgjigjej.

«Sikur të hesht, s'është as e drejtë as e njerëzishme. Në fund të fundit, unë duhet t'i sqaroj atij se cila jam dhe çfarë mendoj. Po sikur të hesht? Po sikur t'ja kthej letrën prapsht? Jo. Këtë s'do ta bëj. Çdo i ri te ne duhet të jetë i ciltër e ta thotë hapur atë që ndjen. Po ç'rrugë t'i tregoj unë atij? T'i mbyll çdo rrugëdalje, çdo derë, çdo shpressë? Ah, zemër, zemër! Vallë vetëm e femrës tundohet kështu?»

Diku Tolstoi shkruan: «Duhet pranuar se zemra e gruas është gjithnjë më e gjerë.»

Luljeta nisi të shkruante, dhe të dyja vetullat e saja ju afroan shumë njëra-tjetërës:

«Astri,

E mora letrën dhe po të përgjigjem.

Ti s'bëre gabim, por faj. Dhe jo një faj, por dy. Ti s'kérkon falje, se u pendove, se e ndjeve fajin. A thua se në dy muaj ti bëre kthesë? Jo. Ti i druhesh punës. Akoma duart e tua s'i kanë folur kokës sate. Po, po. Mos prit fjalë të ngrohta nga unë. Unë kérkoj që ti të formohesh si njeri në mes të atyre njerëzve të mirë. Ti s'po kérkon falje, se u pendove... por se djersite disa ditë...

Nuk e di nëse do të takohemi përsëri, por nëse takohemi, unë dua të shoh te ti një njeri të ndershëm...

Luljeta shtoi në fund të letrës një «të fala» të thatë, e firmoi, e mbylli e pastaj nxori nga xhepi një pullë poste. Në fillim desh ta njomte pullën me ma-

jën e gishtit. Pastaj u mendua një çast: Ju kujtua nata te stoli, ju kujtua shoqja në errësirë... Përfytyroi atë natë anës liqenit, përfytyroi atë gruan e fakultetit... pastaj ju kujtua Tolstoi, ju kujtua ai vargu i asaj poezisë «Për të pritur prapë mëngjeze..» ...psherëtiu dhe e njomi pullën me majën e gjuhës...

## AJO... FSHATARJA...

Shiu kishte pushuar; nga pullazet e shtëpive rridhnin rrëkeza të vogla, duke krijuar kështu një zhurmë monotone mbi kaldrëm.

Nga fletët e mollëve rridhete uji i shiut dhe dukej se do të lante vendin përreth. Për disa çaste dolli dielli e u duk se gjithshka aty u përtëri.

Nifja, me këmbët e zbatura mbi barin e njomë, rrinte pështetur te gardhi. Vështroi Havanë, që po largohej, dhe u drodh përbrenda.

«Mos më gënjeu...»

Desh të vravonte pas saj, ta pyeste prapë, por qëndroi në vend, me buzët të shtrënguara, që i dridheshin. S'po kuptonte ç'kishte. Pse dridhej kështu? Ajo duhej të gëzohej... Havaja s'mund ta gënjen. ...ajo sapo ishte kthyer nga qyteti...

Hyri brenda. Mbi dërrasat e verdha të dyshemësë la gjurmët e këmbëve të lagura. U vërtit për disa çaste, duke kërkuar diçka. Niëherë mori kënuët, pastaj çorapet... hapi sëndyqin dhe nxori një fustan të ri me lule të bukura... e ngriti, e pa mirë e mirë dhe e lëshoi mbi minderin e lartë të dhomës.

I mori pastaj rrobat në dorë dhe filloi të vërtitej me to, sikur të fshihej nga dikush...

Nuk është ta merrte vesh njeri atë që dinte ajo.

U vesh dhe doli në dhomën tjetër. E vjehrра merrej me djalin e saj të vogël. Nifja u afrua te vatra, pastaj mori të birin, e ngriti lart dhe e puthi fort. Ai guiste pas saj, ngatërronte gishtërinjtë e njomë në flokët e butë të saj, ja tërhiqte... e ajo e shtrëngonte pas vetes. Pastaj e la përsëri në djep. Sytë e saj gështenjë lëshonin xixa nga gëzimi... E vjehrра tundi kokën lehtë, buzëqeshi dhe vazhdoi të përkundte të nipin...

Nifja shkoi te praku i derës, qëndroi aty disa çaste dhe, duke u larguar, doli shpejt:

— Që sot do të kthehem, nëno... që sot! Sa të marr vesh...

Me këpucët në dorë, Nifja ecte shpejt. Këmbët i vriteshin pas guriçkave të udhës e i digjinin nga balta dhe uji i ftohtë... po ajo nxitonte të arrinte autobusin, që shkonte për në qytet.

Në një përrua, në të dalë të fshatit, lau këmbët, veshi këpucët dhe rrëgulloi flokët me dorën e lagur.

Ndjeu se balli i kishte djersitur e ftyra i që nxehur e i nxirrte një afsh të ngrohtë.. kishte ecur shumë. Këmbët s'i ndjente fare, po edhe lodhje s'ndjente.

«Sa të vete, — mendonte, — sa të vete të pyes... nuk do të rri fare!»

Në autobus shikonte si e trembur sa andej-këndeji. Nuk i zuri syri asnje të njobur. U tulat në vendin e saj, fshiu me pëllëmbë perden e hollë të avullit në xham dhe e treti vështrimin jashtë, andej nga i kalonin me shpejtësi arat, përrrenjtë dhe ko-

drat e mbuluara më një gjelbërim të ri. Aty më lart hapnin tarraca. Nifes i ardhë deri aty tingëllimi i kazmave dhe melodia, që këndonin...

Po i dukej rruga e gjatë. Asnjëherë nuk i qe dukur kaq e gjatë sa sot... Deri tani nuk kishte kujtuar asgjë. Cudi! Tani ishte si i dehur nga lajmi që kishte marrë dhe nuk po e mblidhte dot veten.

Ndjente vetëm që ishte e gëzuar, po nuk e shtronte dot arësyen.

I doli parasysh i vëllai... sa e kishte marrë malli për të. Se ajo vetëm atë kishte nga dera e të atit. Nëna, babai i kishin vdekur dhe e kishin lënë të vogël bashkë me të vëllanë. Ishin rritur nëpër dyert e botës. I vëllai kishte ikur nga fshati dhe ishte bërë shofer në qytet. Atje dhe ishte martuar, këtu e katërmëbëdhjetë vjet më parë. Pas ca vitesh ishte martuar edhe Nifja. Ajo jetonte aty në fshat. Jetonte mirë; kishte tre fëmijë dhe ishte e lumtur...

I vëllai jetonte në qytet vetëm me të shoqen. Ai e donte të motrën, i bëhej qejfi kur e shihte, e merrte malli për të, por... e kunata s'e donte Nifen. Vetëm këtë s'arrinte ta kuptonte kjo.

«Pse të mos më dojë? Unë kam shtëpinë time, ajo të sajnë. Unë jam fshatare, ajo qytetare... Punë e madhe se është qytetare! Po vëllai im, a s'është fshatar? Ajo duhet të më dojë... se unë vetëm atë vëlla kam...»

Nifja fshiu përsëri xhamin e drithares së autobusit. Mbështeti ballin pas xhamit dhe si hiqte sytë nga rruga, që kalonte me shpejtësi. Nifja u ngazëlliye aq shumë, sa u ngrit më këmbë e filloj të vështronte tamam si ata fëmijët. Një ushtar, me një

aparat tē madh nē shpinë, rendte tē arrinte shokët.

Diku, pas një kthese, shtrihej një lëndinë e vogël, e blertë, me ca shkurre përgjatë saj. Nifja buzëqeshi lehtë. Sytë i shndritën nga një gaz i brendshëm dhe kafshoi buzët ngadalë... aty, gjithë ajo rrugë, që i kalonte me shpejtësi, qe e mbushur plot me lule... lule kaçë tē verdha e tē freskëta, që dukej sikur kishin çelur pas shiut dhe akoma mbanin lëngun nē petalet e holla e delikate...

Nifja ndjeu padashur ngrrohtësinë e pranverës, që po shpërthente papritur para syve tē saj.

«Po pse tē mos më dojë, pse?

Filloi ta brente ky mendim. Unë kurrë s'e kam bezdisur për asgjë... apo, nuk ka dhimburi për assjeri... kjo ndoshta vjen se nuk ka fëmijë... s'e ka provuar tē jetë nënë... thonë se nënët duan shumë...

Nifja trokiti nē derën e tē vëllait, trokiti lehtë, pastaj e tërhoqi me shpejtësi dorën, kafshoi gishtin dhe priti sa tē qetësohej... se zemra po i rrihte fort. Trokiti përsëri, por s'ju përgjegj njeri. Filloi tē shihte rrëth e rrotull. Askush nuk dukej. Atëhere u ul te shkallët e mëdha tē pallatit dhe priti. U hap një derë dhe dikush doli. Ishte Sanija.

— Uh, Nifja! Po ti, ç'bën këtu? Pse nuk hyn brenda? — Nifja u tremb e u duk sikur u zgjua nga një gjumë i rëndë.

— Sanija!.... ja, po pres sa tē më vijë ime kundë. — Ato u përqafuan dhe i shtrënguan dorën njëra-tjetrës.

— Moj, Nife, sa mirë qenke më shëndet! Që vjet ke ndryshuar shumë, tē mbaj mend, kur ardhe vjet, ishe e zhetë, tani...

Nifes i shkëlqyen sytë. Sanija i fliste sikur ta

kishte motër... sa mirë sikur edhe e kunata t'i fliste kështu!

Nifja s'fliste, s'po e pyeste për asgjë. Akoma jetonte me ëndrrën e saj, me lajmin që kishte marrë atë ditë. Prandaj s'deshite të pyeste asnjë, as Sanjen, që ju tregue aq e dashur... ajo kishte dëshirë ta shihte vetë, ta pyeste vetë...

Sanija diç u kujtua në çast:

— Nife, hajde tani, mjafit ndenje këtu jashtë, ne kemi shtëpi... yt vëlla vjen për drekë... edhe kunata, po deshe, dërgoj djalin të ta thérresë vëllanë.

— Jo, jo! — Nifja kërceu përpjetë sikur dikush do t'i merrte diçka të dashur, të dhemshur.... — Jo!

Sanija s'foli. E pa që Nifja s'dëgjonte dhe hyri brenda e habitur. Dolën edhe fqinjë të tjerë dhe e ftuan Nifen të hynte brenda, por ajo s'dëgjonte:

— Jo, jo. S'do të rri, vetëm një fjalë kam dhe do të iki. Nifja po priste me ankth. I vëllai s'vonoi të vinte. Ajo hyri brenda pas tij dhe s'po çmallej dot. Zemra dhe duart i dridheshin.

— Nife, po si e gjete rrugën! Ke kaq kohë që s'ke ardhur!

Në çast kërciti dera e jashtme. Ishte ajo, kunata e Nifes.

Tek dëgjoi zhurmë brenda në kuzhinë, i mbajti hapat dhe qëndroi. Hoqi pardesynë dhe po e varte në portmantonë me pasqyrë në korridor. Ajo e njoihu nga zëri të kunatën, se e dëgjoi tek thoshte:

— Mora vesh se Ditka është shtatzanë. Për këtë ardhë deri këtu... është e vërtetë?

Ditka u drodh aty përjashta. Padashur hodhi syste te pasqyra dhe me sytë të turbulluar nga turpi e pendimi e pa fytyrën e saj si nëpër mjegull, si nëpër cipën e ujit që e fryn era...

## PRANVERË VAJZËRIE

— Ja, e dëgjoni? Ardhi...

Nëpër natë u dëgjuan telat e shkujdesur të një kitare. Nusha s'foli. «Po mirë që ardhi. Ai këndon bukur. Pastaj... ne të gjithave na pëlqen...»

Liza shoqti dritën, hapi dritaret dhe u shtri në krevat. Në dhomë hynë tingujt eëmbël të kitarës....

Ai që i binte kitarës kishte kohë që vinte poshtë dritares së tyre. Dhe i binte bukur. Edhe këndonte. Këto ishin ndoshta netët më të bukura. E secila nga ato të gjashta (që ishin në atë dhomë) sesi e ndjente veten: tingujt e kitarës sikur jua tretnin të gjitha gjymtyrët, e ato kridheshin në një ëndërrim tëëmbël. Zaten, për studentët që jetojnë në konvikt këto net janë bërë të zakonshme... dhe përsëri janë shumë të bukura...

— Monda, po ti, e pregete seminarin për nesër?

— Aman, Nushë, pusho, të keqen. Harroji seminaret tani... nuk dëgjon sesa bukur këndon? E di që më është mbushur mendja se ai këndon për ty?

— Për mua? Po unë... mua ai s'më ka thënë asgjë.

— Pse, me shkrim e do ti? Po dashuria kështu

e ka, moj e gjorë. S'di llafe... ohu... kam inat kështu kur kërkon të hiqeni... unë për vete u dashurova me një shikim. Koçua im...

Ato e kishin dëgjuar kushedi sa herë rrëfimin e Mondës për «Koçon e saj». Dhe ajo s'përtonte ta tregonte, jo një herë, por dhjetë herë në ditë... «Ai Koçua im...»

Nusha hoqi çarçafin dhe vuri duart në fytyrën e bërë prush.

«Vërtet, po ai pse vjen çdo natë nën dritaren tonë? Po atë ditë, të premten, që ardhi pa rënë nata, pse u skuq kur më pa në dritare? Apo ndoshta s'e kishte me mua? Ku dihet, me ndonjë nga të katit të dytë. Dhe unë budallaqja e mylla shpejt dritaren! Me siguri ndonjë nga ato të katit të dytë do të ketë qenë. Dhe kjo Monda, s'më lë një minut rehat!»

— Dëgjo, Nushë, dëgjo, se në Kukës s'ke për ta dëgjuar më... aha, atje vetëm çiftelisë dinë t'i bien.

— Jo, kanë mësuar edhe kitarën tani, në shtëpinë e kulturës...

— Prapë me «kulturën» ti? Lëre, moj, atë, një i bie kitarës atje. Të tjerët çiftelinë kanë.

— Po mirë ç'të keqe ka? Mua më pëlqen çiftelia.

— Me siguri ky duhet të jetë korçar, — tha Drita ngadalë.

— Korçar? Po pse, do mend shumë kjo? Ju kam thënë: Zgjidhni djem korçarë.. këndojnë dhe i bien kitarës. Këto do jeta: këngë, dashuri...

— ... dhe punë.

— «Dil, moj, në dritare...» — vazhdonte kënga...

— Aman, Nushë, dil, se ai po çmendet!